

Biljana Shotarovska
Tatjana Gjeorgieva

NJOHJA ME RELIGJIONET PËR KLASËN E PESTË



Autorë:

Biljana Shotarovska
Tatjana Gjeorgjievaska

Redaktorë:

Biljana Shotarovska
Tatjana Gjeorgjievaska

Recensentë:

Trajçe Stojanov
Liljana Stefanovska
Daniella Nikollovska

Lektor i botimit në maqedonisht:

Emilija Veličkova

Përgatitja kompjuterike:

Bazhe Tofillovski

Përkthyes:

Ismail Ameti

Redaktim profesional:

Prof. Dr. Agim Poloska

Lektor i botimit në shqip:

Rolland Poloska

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë

Shtyp: Qendra Grafike shpkpv, Shkup

Tirazhi:

5.400

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr.10-1265/1 datë 17.03.2010 lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски", Скопје
373.3.016:2(075.2)=163.3
ШОТАРОВСКА, Билјана
Запознавање со религиите за петто одделение / Билјана Шотаровска,
Татјана Ѓеоргиевска . - Скопје : Министерство за образование и
наука на Република Македонија, 2010. - 105 стр. : илустр. ; 30 см
Лексикон и помалку познати поими: стр. 100-103
ISBN 978-608-226-012 9
1. Ѓеоргиевска, Татјана[автор]
COBISS.MK-ID 84091658

Nxënës të dashur!

Fillon viti i ri shkollor. Me siguri jeni të padurueshëm për atë se çka ju pret këtë vit, në të cilën fillon një periudhë e re në jetën tuaj. Do të njiheni me lëndë të reja mësimore, ndër të cilat edhe me lëndën Njohja me religjionet. Të lumtur jemi që mund t'ju mundësojmë libër të ri për religjionet, në përputhje me planin dhe programin e ri mësimor për klasën fillore. Shpresojmë se të shumtit që do ta zgjedhin do t'ju ndihmojë të mësuarit e besimit, religjioneve, kulturave gjatë civilizimit njerëzor. Me ndihmën e temave të kësaj lënde, si dhe temat e lëndëve të tjera do të njiheni me botën në të cilën jetoni. Bëhet fjalë për libër, respektivisht koleksion të teksteve, fotografive dhe ilustrimeve, të cilat duhet të hulumtohen, dhe për të cilat vlen të mendohet dhe të bisedohet ndërmjet veti, dhe jo si libër që duhet të mësohet përmendësh. Temat për të cilat do të flitet, do të gjykohet dhe mësohet janë të ndryshme, por, megjithatë të gjitha janë të lidhura midis tyre. Udhëtimin tonë të përbashkët e fillojmë duke u njoftuar me besimet e lashta që kanë ekzistuar te njeriu primitiv, kurse pastaj njohja me religjionet e ndryshme antike dhe bashkëkohore.

Shpresojmë që ky libër me tekste, fotografi dhe ilustrime të pasura do t'ua zbulojë bukuritë e jetës, shoqërimin, të përbashkëtën, besimet. Besojmë se do t'ju ndihmojë në kultivimin e dashurisë së vërtetë, solidaritetit, çiltërsisë ndaj të gjithë atyre me të cilët jetojmë dhe bashkëpunojmë. Leksikonin e fjalëve dhe koncepteve më pakë të njohura, të cilat gjenden në fund të librit, mund t'i shfrytëzoni për rikujtim dhe përsëritje kur të keni nevojë.



**EJA TË BETOHEMI SE PREJ SOT
VETËM TË VËRTETËN DO TA
FLASIM**

**EJA TË BETOHEMI SE PREJ
SOT NË VEND TË VUAJTJEVE
TA SHTRIJMË DORËN**



TEMA 1. PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

Njeriu gjithmonë ka dëshiruar që t'i sqarojë dukuritë, të cilat manifestohen në botë. Ka pasur dëshirë të dijë sekretin e paraqitjes së jetës. Këto pyetje, të vjetra sa edhe njeriu i parë në tokë, në fillim, e detyruan njeriun shkaqet t'i kërkojë në diçka mbinatyrore.

- **Të qenët religjioz**
- **Ç'është religjioni ?**
- **Përkufizimi i koncepteve politeizëm dhe monoteizëm**
- **Kur dhe ku ndodhën besimet e para fetare**
- **Njeriu – natyra – fuqitë natyrore**
- **Bashkëpunimi dhe lidhshmëria, në vend të përçarjes**
- **Njerëzia**
- **Religjioni dhe etika**





TË QENËT RELIGJIOZ

Prejardhja e botës dhe të kuptuarit e ekzistimit

Krijimi i botës, të qenieve të gjalla dhe të gjitha gjërave në të ka nxitur varg pyetjesh qenësore, të cilat njeriu i parashtrroi qysh në kohërat më të vjetra. Si dhe kur është krijuar bota ? Kush e krijoi njeriun ?

Njeriu nuk pushoi së pyeturi nga vjen dhe ku shkon. Në atë gjurmim për përgjigje, e cila do t'ia zbulojë ose sqarojë të kuptuarit e ekzistimit të tij, ai i krijoi idetë religjioze, besimet dhe mësimet, të cilat mbijetojnë në botë qysh nga koha parahistorike.



Njeriu nuk pushoi së pyeturi nga vjen dhe ku shkon.



Njeriu primitiv shikonte në dukuritë natyrore si dukuri perëndie

Edhe përkundër faktit se njeriu është i rrethuar me një natyrë të shkëlqyeshme me të gjitha begatitë në të, nuk mund ta mohojë praninë e së keqes dhe vuajtjes. I vëren katastrofat natyrore, sëmundjet, dobësitë si dhe i vëren problemet në raportet ndërnjerëzore (ndeshje, dhunë, luftëra, varfëri, uri dhe padrejtësi).



Njeriu pyetet :

Pse është kështu?

Prej nga rrjedh e keqja ?

Si të ballafaqohem me vuajtjet ?


Pse jeta nuk është përherë e bukur ?



PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

Të besuarit në diçka mbinatyrore i ndihmoi njeriut t'i tejkalojë rreziqet dhe të panjohurën. Prandaj themi se besoi në mbinatyroren, e cila nuk kishte formë fizike (materiale).

Të qenët religjioz u paraqit edhe si përgjigje e shumë pyetjeve të rëndësishme të jetës, siç është besimi në jetën pas vdekjes, që u ndihmoi njerëzve më lehtë të ballafaqohen me vdekjen. Vetëdija për vdekjen shkaktoi te njeriu dëshirën, që ajo të mos jetë fundi i ekzistimit të tij.



Mëso më tepër:

Hulumto a ekzistojnë besime fetare dhe zakone në çdo kulturë!




Mbaj mend:

Të qenët religjioz, domethënë se njeriu ndonjë qenieje mbinatyrore i jep madhëri dhe fuqi.



Të mendojmë dhe të përgjigjemi :

1. Me cilat pyetje është ballafaquar njeriu në të kaluarën?
2. Vallë ato pyetje i parashtron edhe sot?
3. Cilat ishin shkaqet e paraqitjes së religjionit?



Asociacione për konceptin religjion!

Gjetja e koncepteve thelbësorë për përcaktimin e konceptit religjion!

ÇKA ËSHTË RELIGJIONI?

Këtë vit do të njiheni me disa religjione të rëndësishme botërore. Do të zbulojmë si ato mundën t'i lidhin të gjithë njerëzit që duhan paqe dhe drejtësi. Pyetemi prej kur dhe ku u paraqit religjioni? Religjioni është i vjetër sa edhe njeriu. Në forma të ndryshme sot është përhapur në gjithë botën në të gjitha shoqëritë dhe kulturat.

Religjioni mund të jetë mënyrë e shpjegimit të shumë sekreteve të jetës, siç janë:

Si u krijua bota dhe njeriu?

Pse ekzistojnë jeta dhe vdekja?

Çka ndodh kur njerëzit vdesin?

Pse ekziston vuajtja?

Si krijohen dukuri të caktuara në natyrë (vetëtimja, shiu, era, vërshime, tërmete etj.)?

Prej nga rrjedhin e mira dhe e keqja?

Duke kërkuar përgjigje në këto pyetje njeriu filloi të besojë vetëm me qëllim që t'i japë kuptim asaj me çka duhet patjetër të jetojë.



Religjioni përfshin në vete edhe përgjigje të disa pyetjeve që i parashtron edhe shkenca.

Ato janë pyetje të thella dhe të vështira.

Përveç këtyre pyetjeve, religjioni, gjithashtu, merret me **sjelljen e njeriut**. E vlerëson dhe e orienton sjelljen e tij kah drejtësia.

Fjala religjion rrjedh prej fjalës latine religare, që dmth. përsëri „lidhshmëri“. Të gjitha religjionet kanë Zot. Ekzistojnë 3 grupe të teorive për religjionet. E para është se religjioni është trillim i një (zakonisht pushtet) grup njerëzish që ta arsyetojnë qeverinë e tyre. E dyta, se është karakteristikë thelbësore e qenies njerëzore. E treta është prirja njerëzore ndaj zbulimit, respektivisht mosnjohja e forcave dhe ligjeve natyrore.

PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

Religjioni njih ekzistimin e dy botërave, fizike (reale) dhe mbireale (shpirtërore). I jep përparësi botës shpirtërore dhe e përcakton si bazë për gjithçka që ekziston.

Shembull; Sikurse produktet që i krijon njeriu kanë krijues, poashtu edhe sipas religjionit bota dhe njeriu kanë krijuesin e tyre Zotin.

Me zhvillimin e ndërgjegjes njerëzore përkrah shpjegimeve religjioze u zhvilluan edhe ato shkencore si përgjigje për krijimin e botës dhe dukurive në të.

Religjioni është sistem i ideve dhe koleksion ndjenjash, të cilat thelbin e botës e shpjegojnë me mbinatyroren. Besimi dhe ndjenja paraqesin pjesë të patjetërsueshme të religjionit.

Religjioni mund të kuptohet si nevojë njerëzore për siguri, ose si burim i të mirës, të vërtetës dhe të drejtës. Ai zë vend të rëndësishëm në kulturën e njeriut modern dhe bashkëkohor. Rituale, simbolet, doket janë, gjithashtu pjesë përbërëse e religjionit. A keni dëgjuar për fjalën ritual?



Mëso më tepër:

Projekt i vogël hulumtimi me qëllim të zbuloni çka është religjioni!

Shfrytëzoje internetin, libra-enciklopedi, fragmente nga revista.

Gjeni dhe analizoni teorinë e Darvinit për krijimin e njeriut kundrejt religjionit.



Mendo dhe përgjigju:

1. Çka nënkupton koncepti religjion?
2. Shpjego me fjalë tënde ç' është religjioni?
3. Jep shembuj për rituale dhe oke!



Mbaj mend:

Koncepti religjion: Qasja e njeriut në lidhje me diçka të mbinatyrshme me qëllim që të gjejë kuptim. Religjioni është i ndryshëm për njerëz dhe kultura të ndryshme.

PËRCAKTIMI I KONCEPTEVE MONOTEIZËM DHE POLITEIZËM

Kuptimi për Zotin

Zoti përshkruhet si i përkryer, qenie mbinjerëzore dhe mbinatyrore. Njerëzit religjiozë besojnë se ai e krijoi gjithësinë. Në disa religjione Zotit i jepen cilësi njerëzore, kurse të tjerat se është nënçmuese dhe e pamundur të imagjinohet Zoti në formë fizike. Disa mendojnë se Zoti është diçka e bukur, kurse të tjerët se Zoti është diçka më tepër se të kuptuarit e njeriut për të mirën.

Midis njerëzve ekziston mendim dhe bindje e ndryshme në lidhje me pyetjen vallë ekziston Zoti? Sipas përgjigjeve dallohen dy pikëpamje të ndryshme. Një pikëpamje është ajo në të cilën nuk besohet në ekzistimin e Zotit. Ajo quhet **ateizëm**. Vjen prej fjalëve të vjetra greke theos – Zot dhe a- negacion (jo) që në përkthim do të ishte mosekzistimi i Zotit. Ata të cilët besojnë në ekzistimin e Zotit quhen **teistë**.

- **Teizim-** besim në Zot ose Perëndi;
Ateizëm – mosbesim në Zot,
(Për të cilin religjioni është rregull e sjelljes).

Politeizëm

Besimi në më shumë Zotëra quhet Politeizëm. Vetë koncepti vjen nga fjala poli që dmth. shumë dhe teo- Zot. Që do të përkthehej si më shumë Zotëra. Politeizmi është karakteristike për religjionet e vjetra pagane. Të cilat janë më shumë rituale dhe ceremoniale. Këto religjione kanë ekzistuar në Greqinë Antike, Romë, Egjipt etj. Në disa religjione politeiste zotërat paraqitën me formë njeriu sikur në mitologjinë Helene, mitologjia Romake, kurse në disa religjione janë paraqitur në formë të kafshës. Ata kanë Zot të veçantë për punë të veçantë në jetë. Athina – perëndeshë e drejtësisë, Demetra – Perëndeshë e pranverës, Afrodita – Perëndeshë e bukurisë, Had – Perëndi e nëntokës etj. Këto janë disa nga shembujt nga kultura e grekëve antikë. Te Sllavët e vjetër u paraqitën një mori perëndish dhe figurash perëndish, të mirë dhe të këqinj. Midis tyre ishte edhe zoti Perun, rrufetar, sundimtar i qiellit, i cili e lëshonte shiun që ta bëjë tokën pjellore. Veles – është Zoti sllav i tokës, ujërave dhe botës nëntokësore. Imagjinohej si gjarpër i madh me brirë dhe mjekër të gjatë. Gjithashtu, edhe Egjiptianët e vjetër ishin politeistë, kurse Zoti suprem i tyre ishte Amon – Ra, Zot i diellit.

Për religjionet fillestare politeiste specifike është idhujtaria, që domethënë adhurim ndaj hyjnive të cilëve u ndërtonin tempuj, skulptura dhe i adhuronin si hyjni ndaj objekteve.



Zoti Slloven Perun, rrufetar
sundimtar i qiellit

Monoteizëm

Religjione monoteiste janë ato religjione të cilat besojnë në një të vetmin Zot. Fjala monoteizëm ka prejardhjen prej dy fjalëve, mono=një, dhe teo-zot, që do përkthehej si njëhyjnore. Besojnë se krijues i botës dhe njeriut është një Zot. Këto religjione janë **judaizmi, krishterimi dhe islamizmi.**

Dallimet më të rëndësishme ndërmjet religjioneve politeiste dhe monoteiste është morali Besim në idhujtari, gjegjësisht adhurimi i idileve në monoteizëm refuzohet.



Mëso më tepër:

Gjej disa religjione politeiste dhe ndërto një poster për to. Hulumto vallë sot është më i përhapur monoteizmi apo politeizmi. Kupto diçka më tepër për besimet në hapësirat tona para paraqitjes së monoteizmit .



Të mendojmë dhe bisedojmë:

Bëj krahasim të monoteizmit dhe politeizmit!
Ku qëndron dallim ndërmjet tyre ?
A ekzistojnë njerëz në ditët e sotme, të cilët besojnë në më shumë zotëra .
Zgjedh ndonji zot prej religjioneve politeiste dhe shkruaj ese për të!
Lute arsimtaren t'ju tregojë diçka më tepër për ndonjë zot / hyjneshë nga religjionet politeiste!



Mbaj mend:

Politeizëm – shumëhyjnor; njohja dhe respektimi i më shumë zotërave.
Monoteizëm – njëhyjnor; besim në ekzistimin e një zoti.

- religjione politeike (besim në shumë Zotra)

- religjione monoteiste (besim në një zot të vetëm)

- mono=një
poli= shumë
teo=zot

- perëndeshë-emër për zotrat dhe shpirtit në religjionet primitive



përmendore Romake e Athinës perëndeshë e urtësisë




Horus zot i Egjiptit të lashtë

KU DHE KUR U KRIJUAN BESIMET E PARA FETARE?

Nuk dimë saktësisht të përgjigjemi në pyetjen ku dhe kur u krijua religjioni. Në bazë të të dhënave të ndryshme të historisë së lashtë me saktësi mund të themi se religjioni ka histori të gjatë. Zgjat aq sa zgjat edhe historia e njerëzimit.

Të zbulojmë kur dhe ku u krijua religjioni...

Në lashtësi njerëzit besojnë në qenie dhe dukuri mbinatyrore. Besimi në qeniet dhe dukuritë mbinatyrore datojnë qysh nga periudha parahistorike, respektivisht **prej vet paraqitjes së njeriut**. Në fillim njeriu ishte gjuetar. Ai besonte në ekzistimin e forcave mbinatyrore të cilat i ndihmonin në gjueti. Këtë shumë mirë e tregojnë vizatimet, të cilat gjinden në muret e shpellave, në të cilat janë paraqitur kafshë dhe skena të gjuetisë. Rreth vizatimeve të tilla me skena për gjueti, njerëzit luanin dhe këndonin, duke imituar gjuetinë.



Vizatime nga shpella Altamira në Spanjë

Religjioni në paleolit (koha e gurit) e vjetër dhe të ri

Rrënjët e besimit fetar shkenca i kërkon në kulturat primitive, të cilat njihen edhe si parahistorike, të egra dhe jocivilizuese, kultura pa literaturë etj.

Parahistori quhet ajo periudhë njerëzore në të cilën nuk ka qenë i njohur shkrim-leximi.



Njeriu primitiv



PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

Në parahistori nuk ka shkrime për besimet, mitet dhe ritualet. Periudha e shkrim-leximit në botën e vjetër fillon rreth vitit 3000 p.e.r., dhe me të edhe era e civilizimeve të mëdha të lashta. Më rëndësi të madhe janë varrezat e gjetura me objekte dhe dhurata të sakrifikuara. Këto zbulime parahistorike tregojnë për ekzistimin e religjioneve të njeriut primitiv.

Derisa njeriu gjuante kafshë për të mbijetuar, varësia e tij prej forcave natyrore ishte e vogël, sepse suksesi në gjueti varej prej forcës dhe shkathtësisë së tij. Gjuetarët primitivë i llogaritnin kafshët të ngjashëm me njerëzit, por të talentuar me fuqi mbinatyrore. Besonin se njeriu pas vdekjes mund të shndërrohet në kafshë dhe e kundërta, se shpirti i të vdekurit mund të kalojë te kafsha. Ekzistonte besim në jetën pas varrit.



Format primitive të varrezave

- Religjionet primitive
- religjione të popujve të shumtë fisnorë

Për jetën fetare të njeriut primitiv dëshmojnë edhe shumë varreza dhe tempuj. Mënyra e varrimit të njerëzve dhe ceremonitë rituale tregojnë në besimin se me vdekjen ata nuk vdesin, por shpërngulen në botë tjetër. Kjo tregon se ka ekzistuar besim në pavdekshmëri. Prej kësaj periudhe hasen edhe figura të shumta – idile të cilëve njerëzit u përkuleshin. Shembull. Përmendorja femër- perëndeshë e pjellshmërisë dhe emi me maskë njeriu – simbol i pjellshmërisë. Më vonë kur filluan ta punojnë tokën filluan t'i përkulën hyjnive të diellit dhe shiut. Në atë periudhë njerëzit ishin të varur nga ajo sa do të jetë pjellore toka, të mbiunit dhe pjekja e bimëve.



Mëso më tepër:

Mini hulumtim të religjioneve ose traditat shpirtërore të vendasve.

Drejtime: Zgjedh religjion ose traditë shpirtërore për të cilën nuk dini, por keni dëgjuar ose përdonjë shkak doni të dini më tepër.

Lexoni hulumtimin tuaj paraxënësve të tjerë ose shkëmbeni punimet tuaja me nxënësit tjerë, që të dini më tepër për religjionet që ata i kanë zgjedhur.



Mendo dhe përgjigju:

Kur u krijuan besimet e para fetare?

Cila periudhë shënohet si parahistorike?

Prej nga mësuam për besimete njeriut primitiv?

NJERIU –NATYRA – FUQITË NATYRORE

Pse u krijua religjioni?

E rëndësishme për këto besime është të kuptohet si ka jetuar njeriu në kushte të tilla, pa ndihmën e diturisë, shkencës dhe teknologjisë, të cilën e kemi sot. Edhe pse njeriu në ato bashkësi ka qenë në gjendje të paktë të diturisë për natyrën, prapeseprapë, ai duhej, disi, t'i sqarojë. Që domethënë detyra jonë e parë do të jetë si ai ka menduar për të. Çka paraqiste ai?

Para shumë mija vitesh njerëzit jetonin në shpella dhe nuk dinin çka është zjarri. Ndodhitë, sikurse goditja e rrafesë në dru, kanë shkaktuar frikë te ata dhe janë pyetur „ Kush është ai aq i fuqishëm që mund të sjellë këtë bubullimë”? Është qenie shumë më e fuqishme se ne! Sigurisht është Zot kur mundet të gjuajë shtiza prej „zjarri në tokë”. Frikoheshin prandaj i dhuronin sakrifica, që të përfitojnë mëshirën e tij.



Në natyrë përherë shikonte lindje të formave. Përkundër faktit që njeriu përherë ishte jo i sigurtë, i brengosur dhe i kapluar me frikë, nuk mundej e të mos mahnitet dhe çuditet në format e llojllojshme që u shfaqeshin dhe zhdukeshin. Frikohesh nga rrufeja, çuditej nga qielli me yje natën, mahnitej me bukuritë natyrore etj.

Në të kaluarën e lashtë njerëzit vinin deri te ushqimi nëpërmjet gjuetisë. Kafshët e egra ishin të domosdoshme për jetën e tyre. Ishin të fuqishëm dhe të rrezikshëm . Prandaj mendonin se në ta ndodhet Zot i fuqishëm. Disa popuj i përkuleshin diellit, hënës dhe yjeve. Njëkohësisht hyjni të ndryshme; zoti i shiut, zoti i luftës, zoti i barinjve dhe shumë të tjerë.

PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

Shumë popuj fisnorë jetonit të lidhur me natyrën dhe e ndjenin fuqinë e saj misterioze. Dukuritë natyrore siç janë stuhia, uria, sëmundjet, tërmetet i llogaritin si fuqi të liga. Besonin se pas këtyre fuqive fshihen shpirtëra. Duke mos mundur që të i shpjegojë dhe kuptojë shkaqet për fenomenet (dukuritë) natyrore, njeriu ndjente frikë dhe pafuqi. Ai nuk dinte t'i parashikojë pasojat prej tyre. Në kushte të këtilla njerëzit ndjeheshin të pastrehuar, të vetmuar, të shqetësuar dhe vështirë mundeshin të përballeshin me to



Mendo dhe bisedo!

1. Në kohërat primitive njerëzit ku e kërkonin Zotin ?
2. Vizato një skenë nga besimet e njeriut primitiv dhe prezantoni!
3. Paraqit qëndrimin tënd vallë besimet, religjioni dolën, ndërmjet tjera, edhe nga padituria njerëzore dhe mallëngjimi për jetë të amshueshme?



Mëso më tepër!

Përpiqu që të gesh të dhëna dhe informacione nga interneti apo ndonjë libër tjetër për kultin e diellit te Maqedonasit e vjetër, si dhe për nënën perëndeshë të madhe nga Govrleva, Shkup.



BASHKËPUNIMI DHE LIDHSHMËRIA, NË VENDË TË PËRÇARJES

Pa dallim të fesë të gjithë jemi të njëjtë

Ekzistojnë popuj të ndryshëm me shumë zakone të tyre, përkatësi fetare dhe gjuhë të ndryshme në të cilin flasim. Bota është lule shumëngjyrëshe në të cilën çdo fletë paraqet një kulturë në botë. Në te jetojnë njerëz të ndryshëm, që jetojnë në shtete të ndryshme, por dhe në të njëjtin shtet jetojnë nacionalite të ndryshme dhe njerëz me besim të ndryshëm, të cilët midis tyre shoqëroren dhe mirëkuptohen.



Të ndryshëm jemi, por njëri pa tjetrin nuk mundemi



Të ndryshëm jemi

Në se shikoni për rreth (në familje, në shkollë, te fqinjët ...) mund të vërejmë sa të ndryshëm jemi. Dallohem sipas ngjyrës së lëkurës, ngjyrës së syve, lartësisë dhe peshës. Të ndryshëm jemi edhe sipas viteve dhe pamjes. Mendojmë ndryshe kemi qëndrime të ndryshme. Besojmë ose nuk besojmë. Prapsepapë bukur na vjen që jemi bashkë. Njëri pa tjetrin nuk mundemi. Të gjithëve na është e nevojshme respekti dhe mirëkuptimi. Respektimi dhe mirëkuptimi i të tjerëve. Që ta realizojmë këtë duhet t'i respektojmë rregullat për marrëdhënie të mira reciproke.

Ejani të shohim ku shpjenë konceptet:

Respektim/mosrespektim

drejtësi/ padrejtësi

Të gjithë dëshirojmë të ndjehemi mirë, prandaj duhet t'u përmbahemi disa rregullave të rëndësishme për raporte të mira ndërnjerëzore.

Janë disa rregulla për raporte të mira ndërnjerëzore dhe punë të mirë në klasën tuaj.

1. Respektoje tjetrin, edhe pse dallohet sipas fesë së tij.
2. Me kujdes dëgjo derisa dikush flet.
3. Lejoni të tjerëve që t'i shprehin mendimet e tyre deri në fund;
4. Mos përfolni
5. Mos i përqeshni mangësitë e të tjerëve;
6. Ke besim në vete.
7. Gëzohu edhe në suksesin e huaj;
8. Të jesh shok dhe mik i mirë dhe ndihmo kur dikush ka nevojë për ndihmë

PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

9. Të jesh shok i sinqertë.

10. Kur dëshiron të tregosh diçka ngrite dorën dhe flit lirshëm dhe sinqerisht.

Duke u njohur me religjionet do të vërejmë ndryshime, por edhe ngjashmëri midis tyre. Sikur në praktikumin e jetës fetare, ashtu edhe në synimin për bashkëpunim të vërtetë reciprok me religjionet tjera, që kanë një Zot. **Bashkëpunimi nuk do të thotë shmangie nga feja jote. Njohja dhe respektimi reciprok na ndihmon më mirë të njihet dhe të jetohet në pajtueshmëri sipas asaj në çka besohet.** Sicili religjion e gjykon çfarë do lloj mosrespektimi e cila kryhet për shkak të racës, fesë, pozitës shoqërore dhe ngjashëm. Shembujt nga historia tregojnë se njerëzit jo gjithmonë sillen tolerant ndaj të tjerëve, nuk jetojnë sipas rregullave morale në librat e shenjtë. E duhet të jemi unitar në luftën për tolerancë, bashkëpunim reciprok dhe solidaritet.



Përshkruaj përmbajtje në temën:
“Një hap i vogël në kohën”



Mëso më tepër:

Gjej dhe prij fotografi nga gazeta për sa më shumë njerëz të ndryshëm që jetojnë në shtetin tonë. Cilat dallime dhe cilat ngjashmëri i vëren tek ata? Prej fotografive të prera mund të bësh kolazh në temën: „Dallimet janë pasuri.”



Mbaj mend:

Respektimi i rregullave është parakusht për raporte të mira ndërnjerëzore!



Mendo dhe përgjigju:

1. Mendoni dhe diskutoni si do të dukej bota sikur të ekzistonte paqe midis popujve.
2. Si do të ndjeheshin njerëzit atëherë?
3. Vallë respektimi i çdo religjioni do të kontribuonte për më shumë paqe ndërmjet njerëzve?
4. Diskutoni për shembuj kur religjioni ka qenë shkak për konflikt!
5. Çka duhet të dimë për konfliktet ndër fetare që të shmangen?
6. Demonstroni situatën në të cilën jeni sjellë mirë. Shembullin tuaj pozitiv tregojeni në familjet tuaja!

NJERËZIA

Njerëzit janë së bashku

Në jetën takojmë bashkësi të ndryshme, dhe ne jemi një bashkësi. Çka presim prej bashkësisë dhe çka jemi të gatshëm të bëjmë, që secili prej nesh të ndjehet i pranueshëm? E rëndësishme është se mundemi të llogarisim njeri për tjetrin, posaçërisht kur na duhet ndihmë dhe kur të tjerit presin që t'u ndihmojmë.

Si dimë se diçka është mirë, kurse diçka tjetër është e keqe? Si të jemi njeri fatlum i gëzuar? Çka duhet të bëjmë që ta arrijmë këtë? Ku është fati im, e mira ime? Shikojmë se të gjithë njerëzit në botë jetojnë dhe e kërkojnë këtë kënaqësi në mënyra të ndryshme. Pra, njerëzit duhet të anojnë kah diçka që quhet mirë, kah diçka që shkakton kënaqësi, fat dhe plotësim. Të menduarit e gabuar shpije kah e keqja. Kështu njeriu duke menduar krijon sistem të **vlërave dhe rregullave morale** sipas të cilave do të sillet.



Sjellja e **drejtë dhe e bukur** nuk janë prodhim apostafat i shoqërisë moderne. Historia tregon se njerëzit kanë menduar për drejtësinë qindra vjet prapa. Fillet hasën në numër më të madh të religjioneve botërore të cilat e theksojnë anën morale të njeriut dhe bashkësisë. E liga është ajo që hidhet si e papranueshme.

Mendime të shkëlqyeshme

****Mbroji njerëzit nga padrejtësia.**

Ciceron

****Jetën e vlerësoj, si të mirë të vetme.**

Seneka

****Prej një të lige, lind tjetra.**

Fjalë e urtë latine

****Të mos të gëzojë dëmi i tjetrit.**

Fjalë e urtë latine



PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

E mira është e kundërta e saj. Çka domethënë morali? Morali jep drejtimin për atë çka është e mira dhe çka është e ligë për bashkësinë dhe për individin në të. Rregullat morale mund të jenë ligje të shkruara, zakone të shkruara ose të pashkruara. Në këtë mënyrë rregullohen raportet ndërnjerëzore . Rregullat morale dallohen edhe në kohëra dhe kultura të ndryshme.



Mëso më tepër:

Gjej disa mendime dhe fjalë të urta mbi të mirën. Shkruaj mesazhin tuaj. (moto)!



Mendo dhe përgjigju:

1. Cilën rregull do ta theksooni për raportet e mira ndërnjerëzore.
2. Shkruaj shembuj për sjellje të mirë!
3. Përshkruaj situatën në të cilën mund të themi se është morale!
4. Propozo të mbahet diskutim për paralelen tënde për ndonjë problem dhe përpiquini ta zgjidhni në mënyrë paqësore



Mbaj mend:

Morali – është tërësi e rregullave të pashkruara, zakone, shprehi dhe norma, të cilat janë të pranueshme në jetën e ndonjë bashkësie. Morali përcakton si duhet të jetë veprimin njerëzor, kurse anëtarët e bashkësisë i pranojnë ato parime si adekuate, në atë mënyrë rregullohen marrëdhëniet ndërnjerëzore.

RELIGJIONI DHE ETIKA

Rëndësia e religjionit në historinë botërore është e madhe. Edhe pse ekzistojnë mendime të ndryshme për madhësinë e këtij fakti, megjithatë padyshim kjo ekziston. Në historinë e secilit popull religjioni është themelor, vlera e parë shpirtërore prej të cilës zhvillohet vetë ai. Ose, me fjalë të tjera, nuk ekziston popull, civilizim që nuk ka religjion. Kjo u takonte fiseve më primitive deri te shoqëritë e sotme .

Etika si mësim për të mirën dhe të ligën është më thelbësore, pjesa më e rëndësishme në jetën e njeriut.

Etika është bërthama e secilit religjion, e cila e udhëzon njeriu në jetë. Ajo e mëson njeriun si të sillet, të ndjehet i vlefshëm, i rëndësishëm, të dijë të zgjedhë, dhe me këtë të ndryshojë kah më e mira.



Në të mund të gjejmë rregulla që duhet t'u përmbahemi. Ai predikon kapituj të caktuar, rregulla morale dhe zbatimimi i tyre, me qëllim që njeriu të jetë i shpëtuar. Por, historia e religjionit tregon se religjioni gjithmonë nuk ka pasur funksion të tillë etik. Shoqëria e parë, nuk shënonte njëkohësisht edhe mirë, por diçka të rreptë, diçka para secilës dridhet (friket). Në mitologjinë greke dhe romake zotërat nuk ishin absolut të mirë (të përsosur), por kishin mangësi njerëzore, dobësi (xhelozia, tallje etj.). Vetëm në religjionet monoteiste, zoti paraqet mirësi absolute dhe ai paramendohet si gjyqtar moral, i cili shpërblen për mirë dhe dënon për të ligë.

Dhjetë urdhërimet e Zotit, të cilat më vonë do t'i mësojmë, janë zakonet e para morale të shkruara dhe themeli i lirisë në formë të rregulloreve dhe normave të shpallura me Musain në Malin Sinai në Palestinë. Religjioni dhe morali plotësohen ndërmjet veti, duke llogaritur se njeriu fillimisht është qenie morale - e lartësuar mbi

PËRCAKTIMI I KONCEPTIT RELIGJION

epshet natyrore dhe instinkte. Morali merr pozitë qendrore në jetën krishtere. Burime të moralit krishterë janë Dhiata e Vjetër dhe Dhjata e Re. Nga Dhiata e Vjetër është pranuar „Dekalogu,, ose `Dhjetë urdhrat e Perëndisë. Gjithashtu, **Kurani** përmban parimin bazë moral – bëni mirë, largohuni të ligës.



Mëso më tepër:

Rregulla e artë ekziston, pothuajse, në të gjitha religjionet në formë të ndryshme.

Ja disa prej tyre:

-Nga Konfuçie ;

Asnjëherë mos bëj të tjerëve atë, që nuk dëshiron të ta bëjnë ty.

-nga Islami;

Nuk është besimtar ai i cili nuk ka dashuri ndaj të afërmit, sikur që ka dashuri ndaj vetes.

-nga Budizmi;

Mos i lëndoni të tjerët në mënyrën për të cilën edhe vetë zbuluat se është vrasës.

-nga Hinduizmi;

Mos u bëni asgjë të tjerëve çka do t'u shkaktojë dhimbje.

-nga Judaizmi;

Ajo që është e keqe mos ua bëni të tjerëve.

-nga Krishterimi;

Ndaj të tjerëve mos u sjell ashtu, siç nuk do të dëshiroje për vetën.



Mendo dhe përgjigju:

Çfarë është dallimi ndërmjet të vërtetës dhe dhe gënjeshtres?

Pse disa njerëz gënjejnë ? Çka është morali?

Mendoni vallë mundet përmes religjionit t'u ndihmohet njerëzve në botë?



Mbaj mend;

Religjioni përfshin në vete etikë.

Etika është mënyrë e të menduarit rreth pyetjeve për të mirën dhe të ligën. Detyra e etikës është të tregojë vlerat e vërteta. Ngul këmbë gjithmonë të kërkosh dhe të tregosh të vërtetën, të jesh solidar dhe i drejtë.

TEMA 2. BESIMET E PARA FETARE

- Animizëm
- Totemizëm
- Sistemi i ndalesave të veçanta- tabu
- Përrallat
- Çka janë mitet?
- Krijesat mitologjike
- Magji
- Magji, religjion, shkencë





ANIMIZMI

Treguam se si në lashtësi njerëzit besonin në krijesa mbinatyrore dhe dukuri.

Por një nga besimet më të përhapura te njeriu fillestar është besimi në ekzistimin e **fantazmave dhe shpirtërave**. Ja një paragjykim që ka mbetur nga një besim i tillë .

Trokit në dru

Ky paragjykim është lloji më i përhapur në viset tona . Çdo herë kur dikush do të thotë diçka të mirë ose nëse i ndodh diçka e mirë, ai do të trokasë në dru dhe do të thotë,, Të trokas në dru që të mos dëgjojë e liga”.

Kjo rrjedh nga besimi vjetër se zotërat jetonin nëpër pemë dhe pyje. Kur dikush vinte te ndonjë nga zotërat për lutje që t'i plotësohet ndonjë dëshirë, duhej fillimisht ta prekë lëvozhgën e asaj peme. Derisa ajo dëshirë i plotësohet më vonë, ai përsëri vinte te pema që të trokasë në të, që ishte porosi prej zotit se dëshira u përmbush, dhe njëkohësisht falënderim. Njëkohësisht ekzistonte besimi se për rreth pemës fluturonin fantazma, të cilat janë xhelozë ndaj fatit njerëzor. Trokitja në dru kishte edhe kuptimin „të shurdhohen“ ato fantazma, me qëllim që të mos dëgjojnë se dëshira është përmbushur.

Ky besim se shpirti është i aftë të mundë të jetojë i ndarë prej njeriut, kafshëve dhe bimëve dhe e njëjta mund të ngjitet me ta, quhet animizëm. Ky besim ishte më i përhapur te njeriu primitiv.

Rëndësia e animizmit si besim fetar qëndron në atë se njeriu beson se të gjitha dukuritë, objektet, krijesat në natyrë ekzistojnë përjetë (amshueshëm). Ata nuk zhduken, nuk vdesin, por fshihen prej tij.

Animizmi në formën më të hershme kishte besimin në fantazma. Bota e njeriut primitiv ishte e banuar me fantazma. Ato i njihte në jehonën, reflektimi i fytyrës së tij në ujë, zhurmave specifike,

ylberit në qiell etj. Ato sipas njeriut primitiv nuk janë truporë dhe nuk mund të preken, por, zakonisht, janë afër tyre dhe kanë ndikim në jetë. Fantazmat në të cilat besonin janë pjesë e natyrës, ato janë të paprekshme, mund të jetojnë në gurë, pemë ose në ndonjë objekt tjetër. Bota e fantazmave është botë e padukshme. Më vonë ajo botë e padukshme mbetej fuqi misterioze dhe ndahej në fantazma të mira dhe të këqija.Të mira konsideroheshin ato të cilat sjellin dobi (dielli, shi), kurse për të këqija ato prej të cilave pësonin dëme (rrufe, vërshime, breshër etj.



Ekzemplar nga animizmi i lashtë



Fantazmë e keqe prej Grenlandës

Shembulli 1.

Në atë moment kur dot fillojë të fshihet shpirti i diellit dhe ne vend të tij shfaqet shpirti i resë, atëherë do të paraqitet edhe shpirti i shiut

Shembulli 2.

Në atë moment kur do të fillojë të fshihet shpirti i borës (me fjalë të tjera kur do të fillojë të shkrihet bora) atëherë shfaqet shpirti i luleve. Atëherë besonin se paraqitet shpirti i pranverës, kurse fshihet shpirti i dimrit.

Shkallë më e lartë e zhvillimit të animizmit është besimi se shpirti jeton i pavarur . Njeriu primitiv mendonte se me dukuri të ndryshme fiziologjike (gju-mi, vdekja, fryma e fundit), udhëheqin fantazma të veçanta nga dëshira e të cilëve varej jeta e njeriut. Shpirti mund të shpërngulet në njerëz të tjerë, në kafshë, bimë dhe objekte. Mendohej se shpirti si dubler i trupit i jep jetë.

Sot dimë se dielli, rrufeja janë dukuri natyrore...



Mëso më tepër:

Hulumtimet për karnavalin e Vevçanit. Vallë rrënjët e karnavalit të Vevçanit tërheqin prejardhje nga besimi i ngjashëm? Çfarë mendoni a është gjallë animizmi sot?



Mendo dhe përgjigju:

1. Çfarë besimi është animizmi
2. A di ndonjë besim në lidhje me animizmin?
3. Trego filmin „ Kasper” dhe diskuto për të me pjesëmarrësit dhe arsimtarin.
4. Cilat fantazma i llogaritnin për të mirë, dhe cilat për të këqij dhe pse?



Mbaj mend:

Besimi se shpirti është i aftë të jetojë i ndarë prej njeriut, kafshëve dhe bimëve, dhe e njëjtamund të bashkohet, por edhe tëndahen prej tyre quhet animizëm.

TOTEMIZMI

Le të kthehemi në të kaluarën e largët, kur njerëzit vinin deri te ushqimi me gjueti. Njerëzit primitivë mendonin se në kafshët e egra ndodhet ndonjë zot i fuqishëm. Kur donin të vizatonin një hyjni, e paraqitnin në formë të kafshës. Dhe sot në disa shpella mund të hasen disa fotografi dhe vizatime të atyre kafshëve. Dhe pikërisht këto vizatime dhe fotografi flasin për religjionin e atyre njerëzve. Ekzistonte besimi se një grup i caktuar njerëzish rrjedh (është në gjini) nga ndonjë kafshë, por kishte raste kur ajo ishte bimë apo objekt. Përveç asaj se njeriu primitiv mendonte se rrjedh prej totemit të tij, ai ndaj tij kishte raport të veçantë. Totemi për të paraqiste diçka të shenjtë, të cilën nuk ka guxuar ta hajë ose mbytë. Ai e ka mbrojtur dhe mbikqyrur në natyrë. Përveç kësaj, njeriu besonte se totemi i ndihmon në jetë prandaj kryente rituale për të dhe i lutej. Nëse ndodhte që dikush ta mbyste totemin e tij, atëherë besohej se fisit do t'i ndodhte fatkeqësi e madhe. Ky besim quhej totemizëm. Vetë fjala rrjedh prej fjalës totem që në gjuhën e indianëve amerikanoveriorë dotë thotë farefisni (stërgjysh). Zgjedhja e totemit varej nga mënyra në të cilën grupi ishte përcaktuar me mjete për jetë.



Totem te fisi indian.



Maska e ariut grizli, e cila mbahej gjatë vallëzimeve rituale të bregut amerikanoverior



Ata që merreshin me peshkim, totem paraqiste peshqit ose ndonjë shtazë tjetër ujore (krokodil, zog deti). Fiset në këto shoqëri edhe vetë njëri me tjetrin dalloheshin sipas totemit të tyre. Kështu jetonte fisi luan, kangur, dem, sokol, mollë, diell etj. Kështu ruhej farefisnia dhe vetëdija për fisin e vet.

Anëtari i grupit, i cili i përkiste totemit, për shembull kangurit, veten e konsideronte kangur, si dhe anëtarët e tjerë të grupit për kangur.

Grupet toteme i ndajnë njerëzit në të tyre dhe të huaj. Me totemizmin janë të lidhura disa kufizime të caktuara në sjelljen dhe komunikimin. Për shembull, burrë dhe grua të grupit të njëjtë totem nuk guxojnë të martohen. Ata njëri për tjetrin janë tabu.

Shumë nga këto besime ekzistojnë edhe sot. Edhe sot ne gjejmë shembuj konkret të totemizmit të ndryshuar. Kështu, për shembull, sot ekzistojnë shumë popuj të cilët në flamurin dhe stemën e tyre kanë kafshë apo objekt, të cilat kanë rëndësi të madhe për veçantinë dhe ekzistimin e tyre. Anglezët kohë të gjatë, por edhe sot për emblemë të tyre kanë drangua. Emblema e Francës është gjeli. Maqedonasit antikë për stemë të tyre kanë luanin. Romakët e vjetër kishin raport të veçantë ndaj ujqve.



Objekt Totemi



Mendo dhe përgjigju:

Çfarë është totem? Si zgjidhej totemi? Përshkruaj shkurtimisht në çka në tërësi besonin njerëzit para mija vitesh.

Analizo vallë ekzistonin ndalesa në fise.

Jep mendim personal për besimin në fuqinë e disa objekteve të njeriut bashkëkohor.



Mëso më tepër:

- Përpuno një totem nga balta.
- Hulumto për objekte totemi të indianëve.



Mbjaj mend::

Totemizmi është besim se një grup i caktuar i njerëzve rrjedh (është në farefisni) prej një kafshe, bime apo objekti.

SISTEMI I NDALESAVE TË POSAÇME – TABU

A keni dëgjuar për fjalën tabu? Çka domethënë ajo ? A e dini se fjala tabu është sjell në Angli nga kapedani Xhejms Kuk në vitin 1777, pas kthimit të tij nga detet jugore. Një nga tubutë më të vjetra është martesë me farefis nga fisi. Sot në vazhdueshmëri ka kuptimin diçka çka nuk guxohet të preket ose diçka që është e ndaluar të flitet.

Tabua paraqitet në Polinezi, kuptimi i fjalës **tabu** mund të përkthehet nga gjuha polake si e **paarritshme**, gjegjësisht e **ndaluar**.

Te popujt primitivë kishe kuptimin ndalesë, e cila i kushtohej ndonjë kafshe, bime,objekti, ndalesë për vrasje, ushqim ose bisedë. Zakonisht totemi paraqet tabu. Por edhe ato dukuri, të cilat kanë ndikim negativ për njeriun kanë karakteristikë të tabusë.

Thyerja e tabusë paraqiste gabim të madh, të nivelit të sotmes vepër kundërligjore dhe tërhiqte dënime të ashpra.

Në Polinezi sistemi i ndalesave përfshinte të gjitha sferat e jetës. Tabuja u paraqit si formë e vetme për rregullimin e marrëdhënieve, duke zëvendësuar

në shoqërinë moderne gjithçka që paraqet moral, religjion dhe drejtësi. Me sistemin e tabuve, gjegjësisht të ndalesave rregullohej se, çka anëtari i grupit të caktuar guxon, dhe posaçërisht çka nuk guxon të punojë (ushqim, marrëdhënie gjinore, të punuarit në ditë të caktuara dhe të tjera).



Ndalesë



Mëso më tepër:

Mblidh të dhëna për ndalesa të caktuara që ekzistojnë sot! (nga librat, enciklopeditë, pyeti prindërit...) A është e ndaluar sot të flitet për ndonjë temë



Mendo dhe përgjigju:

1. Çka domethënë fjala tabu?
2. Prej nga rrjedh kjo fjalë?
3. Çka llogaritej për tabu në totemizëm?
4. A kishte pasoja për atë që e thyente tabunë?

PËRRALLA

Përrallat u krijuan nën ndikimin e traditës gojore. Në përmbajtjet e përrallave gjithmonë ka konflikte ndërmjet të mirës dhe të ligës, të cilat zakonisht mbarojnë me fund të lumtur. Çdo kulturë dhe rajon gjeografik në botë ka përrallat e veta popullore, por motivet përsëriten në shumë kultura. Nëpër to gërshetohen emocionet njerëzore, siç janë dashuria, trimëria, mirësia dhe të ngjashme.

Na ishte një herë në një mbretëri ...

Ku flitet për zanat, për princat dhe princeshat ose për llambat magjike?

Përralla, i përshkruan ngjarjet, të cilat u dedikohen zanave ose krijesave të tjera mbinatyrore (Nganjëherë të mirë, kurse nganjëherë armiqtë e mirës), si, për shembull, shkurtabiqët, shpirtligat, trolli, sirena shtrigat dhe të ngjashme, të cilat, zakonisht, janë më të vegjël se njeriu. Por, ndonjëherë përrallat përfshijnë edhe ngjarje mbinatyrore, të cilat i përjetojnë fëmijët, rinia dhe të tjerë. Gjithashtu, edhe përrallat edhe mitet flasin për ngjarje mbinatyrore. Por, për dallim nga mitet, përrallat ndodhin në kohë dhe hapësirë të pacaktuar (për shembull, „ Ishte një herë në një mbretëri ...” etj) dhe si më e rëndësishme, ato nuk kanë karakter të shenjtë, siç është rasti me mitet, por oli i tyre është zbavitës dhe gjithmonë në vete ngërthejnë porosi edukative.

Përrallat, zakonisht, tërheqin vëmendjen e fëmijëve, të cilët lehtë i kuptojnë personazhet në të. Ato edhe sot janë inspirim për numër të madh veprash.



Tradita gojore e përrallës paraqitet shumë përpara para paraqitjes së përrallës së shkruar. Në vend që të jenë të shkruara ato vetëm tregoheshin si tregime të bartura gjeneratë pas gjenerate. Përrallat më të vjetra të shkruara rrjedhin nga Egjipti i vjetër. Përrallat që janë gjetur gjatë kulturave të ndryshme kanë gërshetime, personazhe dhe motive shumë të ngjashme.

Hans Kristijan Andersen është shkrimtar i njohur i përrallave. I lindur në Danimarkë, 1805. Përralla më të njohura të tij janë: „Sirena e vogël“, „Gishtëmadhja“ dhe „Këpucët e kuqe“.

Jakob dhe Vilhem Grim janë vëllezër, të lindur në Gjermani, të cilët, gjithashtu, janë ndër shkrimtarët më të shkëlqyeshëm të përrallave. Përmbledhja e vëllezërve Grim i përfshin edhe përrallat „E Përhitura“, dhe „Princi bretkosë“...



„Princi bretkosë“



Mëso më tepër:

1. Bisedo për tregimet dhe vallë ato u ndihmojnë njerëzve që të njihen
2. Çka është përralla?
3. Vizato vizatim për ndonjë përrallë, duke pasur kujdes në renditjen e ndodhive.
4. Bëni poster për përralla ose mite



Mëso më tepër:

Trego për ndonjë përvojë në lidhje me emocionet, që ke pasur të gërshetuara në ndonjë përrallë



Mbaj mend:

Përrallat janë tregime në të cilat flitet për krijesa reale dhe joreale. Ato në vete ngërthejnë mesazhe këshilluese.

ÇKA JANË MITET?

Në mitet shprehen përpjekjet e para të njeriut për të shpjeguar botën.

Tani do të na shpjegojë Smiglna, „Sunduesi i unazave”.

Mitet janë tregime që insistojnë të shpjegojnë si funksionon bota. Tregimet janë të vendosura atje larg në të kaluarën. Njerëzit përherë kanë pasur pyetje sikur: „Si u krijua bota jonë”, ose „Pse ekzistojnë vetëtimat”? Disa nga mitet përgjigjen në këto pyetje.



Smiglna është rojtar i diturisë.

Miti si mjet për shprehje ekziston në të gjitha kulturat e gjithë botës. Pa dallim në atë se ato kultura kanë ndikim ndërmjet tyre apo janë të ndara edhe kohore edhe hapësinore, miti gjithmonë ekzistonte. Ai ekziston te Grekët antikë, në mbretërinë Romake, te Sllavët e vjetër, ndërmjet Vikinzëve dhe Keltëve, në Indi, por edhe në ato kultura për të cilat llogaritet se nuk kishin kurrfarë pika të përbashkëta me këto civilizime, ndërsa të tillë janë Inkasit dhe Maitët në Amerikën Jugore. Domethënë mitet janë dukuri e patjetërsueshme të kulturave të të gjithë popujve në botë.

Në to, zotërat ose „super krijesa” i shfrytëzojnë fuqitë e tyre që ndodhin disa punë, ose tregimet janë aventura të zotërave, hyjnive, gjysmëzotave dhe heronjve. Ata mund të flasin për krijimin e botës, mund të jenë për fitoren, për tragjedinë (humbje të diçkaje), nderit (të bëhet diçka e përkryer). Anëmbanë botës, mitet mbetën pjesë e kulturës njerëzore. Kaluan prej gjenerate në gjenerate. Mite të ngjashme ka në shumë kultura, me ndryshim të ndodhive ose karaktereve. Për shembull të shumtën e kulturave, popuj ose grupe njerëzish kanë mitet të tyre. (versionet të miteve), si u krijua bota. Për njerëzit në atë kohë mitet ishin sikur shkenca meqë jepnin sqarime për disa ngjarje. Sot dimë si mitet nuk janë të vërteta. Disa tregime mund të duken të pamundshme, kurse shkenca na jep shpjegime të ndryshme për disa pyetje tona. Por, njerëzit në botë edhe më tej dëshirojnë t’i lexojnë mitet dhe dëshirojnë të mendojnë për rëndësinë e tyre.

Fjala „mit”, rrjedh prej fjalës greke „mythos”, që d.m. th. “gojore”.

Mitet hasen në filma vizatimorë. E kemi shikuar Herkules, kurse në filmin “Sunduesi i Unazave”, flitet për krijimin e botës.

Përmbledhja prej miteve nga disa religjione, bashkësive etnike dhe tërësive gjeografike quhet **mitologji**.

Disa prej këtyre miteve na flasin për **krijimin e kozmosit - botës**



Tempulli Minerva (Romë)

Zeusi- zot suprem nga Mitologjia greke

Tregimet në të cilat pjesëmarrës janë krijesa mbinatyrore (zotër, heronj, gjysmëzotër, etj) quhen mite. Miti sipas prejardhjes së emrit thjeshtë shpjegohet si tregim, ajo e cila tregohet, përshkruhet, rrëfëhet.

Në disa prej miteve të tilla toka është filim i çdo gjëje, prej tokës janë krijuar gjithçka që ekziston. Derisa të tjerë hasim se gjithçka është krijuar nga uji ose nga ndonjë vezë kozmike.

Ekzistojnë edhe mite, të cilat e sqarojnë **prejardhjen** e disa gjërave, për shembull misri, duhani, uji, kafshët ose të cilat flasin për prejardhjen e zjarrit (miti për Prometejin), për prejardhjen e sëmundjeve dhe vuajtjeve (Miti i kutisë së Pandorës) etj. Këto mite i kemi në të gjitha mitologjitë, me atë që në disa sisteme mbisundojnë mite të caktuara, të cilat janë më të rëndësishme. Për shembull, në mitet Amerikane më kryesore janë mitet për prejardhjen e misrit (si produkt themelor ushqimor), në të njëjtin kuptim në të cilin më kryesor është zoti i shiut (si i domosdoshëm për rritjen e misrit)

Dallimi prej tregimit të thjeshtë, përrallës, mitin e ka në atë që shpreh punët më thelbësore, kryesore të jetës në botë. Kështu, për shembull, në to flitet për krijimin e botës, për fuqinë e natyrës, për prejardhjen e njeriut ej.



Fati i njerëzve ishte në duart e Zotërave



Mëso më tepër:


Hulumtoni pse në çdo religjion, tradita ka tregime për krijimin e botës? Pse ekzistojnë aq mite për krijimin e botës, të cilat i krijuan popujt të ndryshëm prej kulturave të ndryshme anembanë botës?

Lexo mitin për krijimin e botës nga mitologjia kineze.



Të mendojmë dhe të përgjigjemi:


1. Hulumto për mitet për krijimin e botës nga popujt të ndryshëm dhe krahaso.
2. Lexo mitin për mollën e artë.
3. Çka është miti?
4. A ekzistojnë sot mite bashkëkohore?
5. Numëro disa nga to?
6. Diskuto në klasën tënde për filmin „Sunduesi i unazave”?
7. Ndërto T – tabelë në të cilën do të shënosh karakteristikat e përrallës dhe mitit dhe vërejtjet dallimet ndërmjet tyre.



Basted-hyjneshtë prej mitologjisë Egjipjane

Kutia e Pandorës

Pandora në mitologjinë e vjetër greke është grua e parë të cilën Zeusi për dënim e përcjollti në tokë. Pandorës i ishte tërhequr vërejtja prej zotërave të mos e hapë kutinë që e kishte pasur si trashëgim. Pandora nga kureshtja e hapi dhe atëherë të gjitha të ligat dolën në tokë - pikëllimi, varfëria, e liga, uria, sëmundjet etj. Ajo menjëherë e mbylli dhe brenda në fund mbeti vetëm shpresa. Atëherë bota mbeti e ftohtë dhe e pikëlluar me plot të liga, prandaj Pandora përsëri e hapi kutinë nga e cila doli shpresa. Kështu njeriu edhe në kohërat e liga ka shpresë .



Xhon Vilijam, Kutia e Pandorës

KËND PËR TË MENDUAR

Miti amerikanoverior

Sipas këtij miti korbi e krijoi botën. Gjuajti guralecë në oqean që të krijojë tokë. Pastaj krijoi pemët dhe barishte, peshqit, shpezët dhe kafshët. Në fund krijoi njeriun nga balta dhe copa druri.

Miti nigerian

Në këtë mit Nëna Voengi ulej në një gur të veçantë dhe ndërtonte njerëz nga një grusht dhe njerëzit, të cilët dëshironin jetë luksoze, i vendoste në një përrua të shpejtë dhe të rrezikshme, kurse të tjerët në një përrua të kthjelltë dhe të qetë

Miti japonez

Japonezët mendonin se Toka dikur ka qenë masë pa formë. Zoti dhe hyjnesha Izanagi dhe Izanami e përziën masën e tillë me shtizë. Gradualisht masa dendësohej, dhe duke rënë nga shtiza u krijua ishulli. Zoti dhe hyjnesha u kurorëzuan, lindën fëmijë të cilët mbetën tetë ishujt japonezë.

Miti i Inkëve

Inkasit rrëfejnë se botën e krijoim „Krijuesi”, Virakoça. Virakoça krijoi tokën, yjet, qiellin dhe njerëzit.



KRIJESA MITOLOGJIKE

Mitologjia është me përplot figura interesante; heronj guximtarë, zotëra dhe përbindështa të rrezikshëm. Të njihemi me disa prej tyre....

Trimat dhe zotrat në mitet antike janë krijesa që kanë përjetuar aventura të jashtëzakonshme dhe fate të çuditshme. Edhe pse ato ishin krijesa që kurrë nuk kanë jetuar, ato përjetuan me mijë vite dhe mbijetuan shumë trima të vërtetë, bile edhe ato fytyra historike, të cilat vetë ishin shpallur për zotër. Të gjithë trimat që janë përfshirë në mitet antike i krijoi fantazia e popujve të vjetër, dhe atë në kohën para gjetjes së parmendës së hekurt, kurse numri dërmues i atyre trimave „jetojnë” edhe sot. Emrat e tyre i hasim në emrat e anijeve kozmike, në veprat e shumë piktorëve dhe skulptorë, në atlaset astronomë. Me figurat e tyre, karaktere dhe veti hasim edhe në shfaqjet teatrale, në veprat e artit muzikor, në bisedat e përditshme. Shumë nga trimat antikë „do të jetojnë” në vetëdijen e njerëzve, derisa të ekzistojë njerëzia, meqë ato janë begati të përgjithshme të të gjitha kulturave dhe civilizimeve moderne. Vetitë, karakteri, aventurat dhe gjithçka nga trimat antikë u krijuan në bazë të burimeve antike, si dhe literaturat e mëdha shkencore, të cilat merren me këtë fushë.



Pegaz është kalë i madh nga mitologjia greke. Ai jetonte në malet e larta. Fluturonte me shpejtësi të erës. Sipas disa burimeve, Pegaz doli (së bashku me vëllanë e tij Hrisaor) nga qafa e Meduzës.

Shembuj për krijesa mitologjike

Kentavër

Sipas mitologjisë helene, kentavri ishte lloj krijese, gjysma e të cilit ishte njeri, kurse tjetra kalë. Jetoi në rrafshin e Thesalisë, në pjesën qendrore të Greqisë dhe ishte mirë i njohur për temperament shkatërrues dhe rebelës.

Himera

Ajo ishte një përbindësh femër, që gëlltiste zjarr dhe një pjesë e saj ishte luan, një dhi dhe një gjarpër. E mundi luftarakun e ri Belerofon me ndihmën e kalit të njohur me krah – pegaz.

Sfinga

Sfinga thuhet se ishte e bija e Himerit. Ajo kishte krah, kokën e gruas, trup të luanit dhe bisht të gjarprit. Në qytetin Teba, sipas legjendës, sfinga iu parashtronte gjëgjëza udhëtarëve dhe nëse nuk e dinin, i mbyste



Herkules



Krijesë mitologjike-kentavër

Feniks

Në mitologjinë e Egjiptasve të vjetër, Feniksi ishte shpend amshueshëm i gjallë. Në çdo 500 vjet e ndizte veten vetvetiu në zjarr të madh dhe përsëri ngjallej, duke u ngritur nga hiri. Gjithashtu, besohej se hiri mund t'i ngjallë të vdekurit, por se edhe me lot mund të shëroj; çfarëdo plagë.

Gjysmëzotëra


Janë krijesa të lindur nga hyjni dhe njeri i vdekshëm. Mes më të njohurve janë: Prometej, Herakle, Akili, Pandora dhe të tjerë.

Herkules

Heraklo është më i njohur sipas versionit romak me emrin e tij – Herkules. Ishte gjysmëzot, babai i tij ishte Zeusi, mbreti i të gjithë zotërave. Heraklo ishte, jashtëzakonisht i fuqishëm dhe guximtar. Duhej të përmbushte 12 detyra dhe gjatë jetës së tij shpartalloi shumë përbindësh.

Gorgoni

Gorgonët ishin gra përbindështa të tmerrshme të cilat kishin fuqi t'i gurëzojnë njerëzit me një shikim. Kishte gjarpinj në vend të flokëve dhe kthetra në vend të gishtërinjve. Në të vërtetë, fjala greke gorgos d.m.th. i tmerrshëm. Meduza është emri i gorgonës më të njohur. Ishte mbytur nga Persej, i cili arriti të ikë pa e shndërruar në gurë, duke shfrytëzuar pasqyrë si mburojë.



Meduza - njëra nga gorgonët

Minotaur

Minotaur ishte gjysmënjeri gjysmëdem. Kishte bisht dhe kokë të demit me brirë të mëdhenj. Jetoj në labirint të ndërtuar nga mbreti Minos. Çdo nëntë vjet Athinasit e kishin patjetër të dërgonin 14 gra dhe burra të rinj të cilët përfundonin si drekë e tij.

Kerber

Kerber ishte qen roje-trekrerësh i botës nëntokësore. Një nga kokat e tij ishte gjithmonë e zgjuar. Heraklo arriti me duar thatë ta zërë Kerberin dhe ta lirojë Tezej nga bota nëntokësore.



Mëso më tepër:

Gjej krijesa mitologjike të tjera dhe shkruaj përmbajtje për njëren nga to.



Mendo dhe bisedo:

1. Numëro disa krijesa mitologjike
2. Cilët krijesa mitologjike i njeh nga mitologjia bashkëkohore?
3. Vizato krijesë tënde mitologjike dhe paramendo mit për të!



Mbaj mend:

Të gjithë trimat, që janë përfshirë në mitet antike, i krijoi fantazia e popujve të vjetër, dhe atë në kohën para gjetjes së parmendës së hekurt, kurse numri dërmues i atyre trimave „jetojnë” edhe sot.

MAGJIA

Magjia paraqet veprimtari themelore dhe praktike e njeriut primitiv në botë. Pse? Sepse njohuritë dhe mjetet e tij në ato bashkësi të para ishin të pazhvilluara, por nevoja për veprimin në natyrë e madhe. Në bashkësi të tillë të pazhvilluar, magjia është veprimi më i rëndësishëm, përmes të cilës njeriu vepron në natyrë. Magjia doli prej dëshirës së madhe të njeriut dhe nevojës të veprojë në natyrën dhe dukuritë e saj.



Skena nga filmi
„Hari Poter”

Paralelisht me totemizmin dhe tabunë vend të rëndësishëm në jetën e njerëzve primitivë zë edhe magjia . Fillimisht fjala magji do të thotë të folurit e fjalëve misterioze ose thërritje e fuqive mbi natyrore, për të bërë diçka që njerëzit e zakonshëm nuk mund ta bëjnë. Magjia është grup i procedurave dhe ritualeve në bazën e të cilit qëndron besimi në forcat misterioze. Në atë kohë njerëzit mendonin se duke përdorur atë mund të ndikojë në njerëzit dhe ngjarjet Disa besojnë se magjia nuk është religjion, por paraqet aftësi të njeriut për të menduar, një lojë shkence primitive. Në kohën e ritualit magjik njeriu kryente veprimet të caktuara, të cilat nuk janë të vërteta, por supozonin se do të arrijnë rezultate të caktuara. Pas magjisë qëndrojnë mendime misterioze. Njeriu fillestar para se të shkonte në gjueti kryente veprime magjike, duke imituar gjahun e kafshës përkatëse, gjatë së cilës imitonte lëvizje që ndodhin gjatë gjahut dhe me vizatime e tregonte vrasjen e kafshës. Veprimet magjike ishin të lidhura edhe punët në fushë, sëmundjet ...

Shembull

Nëse kohë të gjatë ekzistonte thatësi në vend të caktuara në të cilin jetonte ndonjë fis që besonte dhe kryente magji, atëherë ekzistonte rreziku që thatësia të shkatërrojë gjithçka që kishin mbjellë ose t’i thajë të gjitha frytet që i shërbenin njeriut për ushqim, kurse lindnin në natyrë. Prandaj njeriu besonte se mund të ndikojë në

shpirtin e shiut dhe ta thërrasë të paraqitet. Atëherë njeriu bënte magji nëpërmjet të cilave besonte se do të ketë sukses të ndikojë në shpirtin e shiut dhe me të do të bëjë të dalin rretë dhe të bjerë shi.

Në magjinë, pra, fuqitë misterioze janë ato që kryejnë veprim konkret ndaj njerëzve. Të besuarit në ato fuqi misterioze do të thotë besim në magji, gjegjësisht besimi në fuqinë e magjisë ishte kushti i parë për ekzistimin dhe efikasitetin e saj, sepse në momentin kur njeriu ndërpret besimin në ato fuqi, ato në realitet nuk ekzistojnë.



Mëso më tepër:

Sot magjia është një lloj zbavitje. Magjistari me duart e tij të shkathtë ose me ndihmën e mjeteve të ndryshme i mashtron shikuesit, dhe ata besojnë se ai bëri diçka të pamundshme. Të gjithë dimë se pas asaj „magjie” fshihet trik i thjeshtë, megjithatë kënaqemi në atë mashtrim të përkërzer.



Mendo dhe bisedo:

1. Si u krijua magjia?
2. Diskutoni për ekzistimin e magjisë në botën bashkëkohore!
3. Bisedoni për filmin „Hari Poter”.



Vallëzim ritual

MAGJIA, RELIGJIONI, SHKENCA

Magjia u paraqit nga procesi i të menduarit naiv të njeriut, i cili ende nuk mundej ta kuptojë lidhjen dhe raportet ndërmjet dukurive në botë. Kjo është karakteristike për vetëdijen primitive. Procesi i të menduarit në të cilën bazohet magjia mbështetet në dy parime; **ligji për ngjashmëri** – ku e ngjashmja prodhohet me të ngjashme ose ku pasoja i ngjan shkakut të saj.

Shembull, gjuetari para se të niset në gjueti fillimisht gjuan me shigjetë në vizatimin e kafshës të cilin shkon ta gjuajë. Parimi tjetër është **ligji i të prekurit ose bartjes**. Sipas disa mendimtarëve magjia i paraprin religjionit. Ajo është sistem i mënyrave rituale. Magjia si sistem i besimit dhe mënyrave nuk është vetme për të gjithë popujt dhe kulturat në botë.



Numër i madh shkencëtarësh kanë qenë religjioz



Mëso më tepër

Shumë shkencëtarë kanë qenë religjiozë. Hulumto për disa nga ata.



Në religjionin bëjnë pjesë konceptet mbinatyrore dhe hyjnore. Religjioni shfrytëzohet me zot dhe mbinatyroren për shpjegimin e fenomeneve, objekteve dhe krijesave në botë. Sipas religjionit mënyra e vetme e lidhjes së njeriut me Zotin është përmes lutjeve dhe bërjes mirë. Në dallim prej magjisë, shkenca me saktësi llogarit se vijimi i ngjarjeve natyrore gjithmonë është i kushtëzuar me ligjet natyrore, respektivisht fuqive natyrore nuk mund t'i shkaktoj njeriu.

Shkenca mendon se bota u krijua nga materia. Prej kësaj duket se shkenca bashkëkohore e shembë pasqyrimin fetar për krijimin e botës dhe njeriut. Megjithatë, tregimi religjiozë për krijimin nuk është studim shkencor. Në pyetje të caktuara të dy fushat dalin në mënyra të veta, gjegjësisht kanë pikëpamjet e tyre. Shkenca e pasuron diturinë tonë në çdo fushë biologji, fizikë, kimi dhe ngjashëm. Religjioni përpiqet të përgjigjet në pyetjen: Cila është esenca e ekzistimit të njeriut dhe botës? Religjioni dhe shkenca kënaqin nevoja të ndryshme të njeriut, prandaj ato nuk janë në kundërshtim dhe nuk përjashtohen.



Mendo dhe bisedo:

1. Përpigu t'i vëresh dallimet ndërmjet shpjegimeve të dukurive në botë me magji, religjion dhe shkencë
2. Luteni mësuesen bashkërisht të përcaktoni për cilën periudhë të historisë është karakteristike shpjegimi magjik, dhe për cilën ai fetar dhe shkencor.



TEMA 3. RELIGJIONET E MËDHA BOTËRORE

- **JUDAIZMI**
 - Dhiata – marrëveshja
 - Krijimi i botës
 - Jeta e Musait (Mojsiut)
 - Libri i shenjtë i Hebrenjve
 - Ligjet e Zotit – Dekalogu
 - Muri i vajit
 - Simbole dhe lutje në judaizëm
 - Festat dhe traditat çifute (hebrenj)
-
- **KRISHTËRIMI**
 - Lindja e Jezuit
 - Apostujtë
 - Predikimi në mal
 - Mrekullitë e Jezuit
 - Kryqëzimi dhe ringjallja e Jezuit
 - Libri i shenjtë në krishterim
 - Simbolet krishtere
 - Bashkësitë e para krishtere
-
- **ISLAMI**
 - Profeti Muhamed
 - Kurani
 - Tempulli i shenjtë në Mekë-Qabe
 - Pesë shartet e islamit
 - Festa më e rëndësishme islame dhe vendi për lutje





Sot në botë ekzistojnë religjione të ndryshme. Ndoshta disa prej tyre i ke njohur në lagjen tënde, në vend ose në shkollën tënde. Midis nesh jetojnë shumë njerëz të fesë tjetër. Ka dhe njerëz që nuk besojnë. Është e nevojshme të njihen bile disa shenja esenciale të religjioneve më të rëndësime botërore. Ne do të njihemi vetëm me disa prej tyre- me ato që besojnë në ekzistimin e vetëm një Zoti.

Kush është themelues i Judaizmit?

Besohet se Ibrahim (Avrami) ishte çifuti i parë dhe themelues i judaizmit. Në kohën u paraqit judaizmi, njerëzit në vendlindje e Ibrahimit, Mesopotamia, besonin në më shumë zotëra. Historia e judaizmit fillon me Ibrahimin dhe Musanë (Mojsiu). Musai është, gjithashtu figurë e rëndësishme meqë i dha çifutëve dhjetë urdhëresat e Zotit, rreth vitit 1250 p.e.r. Torata (pjesë e Dhiatës së Vjetër) i përmban këto urdhëresa të Zotit.

Hebrenj, ashtu quheshin Izraelitët prej shek. 6 p.e.r. pas kthimit nga robëria babilonase .



Zgjedhja e hebrenjve për popull hyjnor filloj kur stërbabai i hebrenjve shkoj nga Ur në Hanaan.

JUDAIZMI

Judaizmi është religjioni më i vjetër monoteist në botë. Ai është religjioni i parë në të cilin besohet në vetëm një zot (Jahve). Në esencë të Judaizmit është besimi se ekziston vetëm një Zot, i cili është krijues dhe sundimtar në gjithë botën. Gjithçka sheh dhe gjithçka di. Në themelet e saja më vonë u paraqitën krishterimi dhe islami. Historia e këtij religjioni shkon prapa 4000 vite, në kohën kur Çifutët ishin popull nomad të quajtur Hebrenj dhe jetonin në Lindjen e Afërt. Ai është religjion, me afro 14 milion ithtarë anembanë botës. Sot më pak Çifutë ka në Izrael dhe SHBA.

Të mësuarit e Judaizmit është shtruar në librin e shenjët Tanah të njohur Dhiata e Vjetër e Biblës.



Ylli i Davidit, simbol i rëndësishëm Çifut. Ajo daton prej shekullit të mesëm, por sot shfrytëzohet në flamurin nacional të shtetit të Izraelit.

Vendi i prejardhjes	Izraeli
Themelues	Ibrahimi (Avrami)
Libri i shenjtë	Tanah (Dhiata e Vjetër)
Shtëpia e lutjës	sinagoga
Vendi i shenjtë	Jerusalemi
Festa të rëndësishme	Rosh Hashanah dhe Jom Kipur, Pasha, Shavuot (Shpirti) Sukkot (shatora)

Zoti i Çifutëve nuk mundet të prezantohet, nuk ka as emër, meqë Jahve në përkthim domethënë „Unë jam ai që jam”.



Mëso më tepër:

Intervistoni person të rritur që është fetar. Ai mund të jetë person nga shokët e tu, familjes dhe ngjashëm, të cilët kishin dashur të flasin për religjionin e tyre.

Shkruani përmbajtje të shkurtë sipas të dhënave që keni marrë.

Pyetje për intervistë

1. Cili është religjioni juaj?
2. Kur ishit fëmijë çka ju la përshtypje më të madhe prej religjionit tënd?
3. Vallë në religjionin tuaj ka vendtubim adhurimi?
4. Si ndikon religjioni juaj në jetën tuaj të përditshme?
5. Çka është më e rëndësishme nga religjioni sot?



Të mendojmë dhe bisedojmë

1. Kur u paraqit judaizmi?
2. Cili është themelues i judaizmit?
3. A e dini religjionin i kujt është judaizmi?
4. Ku u paraqit ky religjion?
5. Ç'është më e rëndësishme nga religjioni sot?



Mbaj mend:

Ithtarët e judaizmit janë Çifutët. Ata besojnë në një zot (Jahve). Judaizmi është religjioni më i vjetër monoteist nga tri religjionet botërore monoteiste. U paraqit në territorin e Izraelit.

Sipas tregimit biblik Zoti i tha Ibrahimit: „Shko nga vendi yt ... në tokën që do ta tregoj. Popull të madh do të bëj nga ty, do të bekoj...”



Ylli i Davidit

Prej nga rrjedh judaizmi?

Judaizmi paraqitet në Izrael rreth vitit 4000 p.e.r



Në çka besojnë Çifutët?

Çifutët besojnë se ekziston një zot, i cili është krijues i tërë botës.

DHIATA – MARRËVESHJA

Në qendër të religjionit Çifut është lidhja ndërmjet Zotit dhe popullit Çifut. Lidhja domethënë edhe obligime të caktuara të këtij populli. Sipas fletëve të shenjta çifute, lidhja e parë është ai ndërmjet Zotit dhe Noe. Baza për të qëndron në atë që Zoti e mbrojti Noen dhe familjen e tij nga fundosja. Lidhja e dytë e zotit është me Ibrahimin, të cilin Zoti e dërgoi në tokë të panjohur, duke i premtuar popull të shumtë në se respekton fenë (marrëveshjen). Dhe se t'ia japë tokën e premtuar Hanaan. Ajo (më vonë e quajtur Palestinë ose Izrael) gjithmonë ka pasur rol të rëndësishëm në kujtimet e popullit çifut. Çifutët shumë herë gjatë historisë kanë qenë të dëbuar, por gjithmonë me mendimet vazhdimisht ktheheshin kah ajo dhe qytetit të shenjtë Jerusalem. Pasardhësi i Ibrahimit është Isaku. Ibrahim është prapind i popullit Çifut. Zoti e thërret Ibrahimin ta lëshoj vendin e tij dhe të shkojë në tokë të panjohur të cilën ai t'ia tregojë. Aty prej pasardhësve të tij do të bëjë popull të madh, nga Zoti i zgjedhur dhe i bekuar. Zoti i premtoi Ibrahimit, se do ta bëjë babë të popullit të madh, në qoftë se e dëgjon dhe nëse e mëson botën në ligjet e tij. Ibrahim, po ashtu është i rëndësishëm edhe për krishterimin edhe për islamin.

Lidhja e tretë e Zotit është me Musanë në malin e Sinas. Zoti iu paraqit Musait dhe udhëhoqi popullin Izraelit kah shpëtimi. Populli Izraelit për këtë të mirë i premtoi Zotit se do ta respektojnë Ligjin (Dhjetë urdhëresat e Zotit).

Çka është interesante në historinë e fesë religjionit dhe popullit çifut,?

Çka është lidhja dhe cila është rëndësia e saj?



Duart e shtrira dhe të shtrënguara qysh në kohët më të vjetra simbolizojnë lidhje – miqësi ndërmjet njerëzve.



Musai e udhëhoq popullin Izraelit nëpër det



*Ibrahim, udhëheqësi i parë i çifuteve, është lindur në Muru, Irak të sotshëm, rreth vitit 2000 p.e.r



Mëso më tepër:

Lexo nga Bibla për Fundosjen dhe lidhjen ndërmjet Zotit dhe Noe.

Lexo nga Bibla për lidhjen ndërmjet Zotit dhe Ibrahimit. Gjej dhe përshkruaj për bashkësinë çifute në R. Maqedonisë.




Të mendojmë dhe bisedojmë:

Pse populli çifut quhej popull i zgjedhur?

Në çka besonin njerëzit para paraqitjes së Ibrahimit?

A është i rëndësishëm Ibrahim edhe për religjionet tjera ?



Mikelangjelo, krijimi i Ademit (Adamit), kapella Sikstine

KRIJIMI I NJERIUT

Nëse e hapim Dhiatën e Vjetër do të shohim se në fillim flitet për krijimin e botës . Ky tregim biblik fillon me fjalët: „Në fillim Zoti krijoi qiellin dhe tokën. Sipas këtij tregimi bota është krijuar në shtatë ditë. Zoti e krijoi botën ne gjashtë ditë, kurse ditën e shtatë pushoi nga vepra e tij. Me fjalët: „Le të jetë...“, fillimisht krijoi dritën. Ditën e ardhshme e krijoi qiellin dhe detin, e pastaj tokën dhe botën bimore. Sipas urdhërit të Zotit në tokë do të mbijë bari, gjelbërim dhe pemë frytdhënës. Ditën e katërt krijoi diellin, hënën dhe yjet. Ditën e pestë shpezët dhe peshqit. Ditën e gjashtë krijoi kafshët, bishat e egra dhe zvarranikët. Në fund Zoti krijon njeriun.

*Adam në gjuhën hebreike d.m.th njeri, njerëzi

*Adamah d.m.th. tokë

*Hava (Eva): nëna e të gjithë të gjallëve

Tregimi për Ademin dhe Havën

A keni dëgjuar cilët janë njerëzit e parë në botë sipas tregimeve nga bibla?

Ademi është njeriu i parë të cilin Zoti e krijoi nga dheu dhe i dha jetë. Nga brinja e tij krijoi gruan Havën. Sipas tregimit Ademi dhe Hava jetonin në kopshtin e parajsës, plotësisht pa bregë. Aty mund t'i hanin të gjitha frytet dhe të kujdeseshin për kafshët. Mirëpo, në kopshtin kishte një pemë të cilin e vendosi Zoti dhe e cila quhej pema e njohjes së mirësisë dhe ligësisë. Zoti vendos një rregull, që Ademi dhe Hava të mos hanë nga frytet e kësaj peme. Mirëpo, Hava një ditë provoi nga frytet e pemës së ndaluar nën mashtrimin e gjarpërit me çka e theu rregullën. Pas Havës, edhe Ademi provoi nga frutat e pemës së ndaluar. Ademi dhe Hava ishin dënuar për atë që vepruan dhe jeta e tyre ndryshoi. Nuk do të jetojnë më pa bregë, por do të punojnë me mund që të mbijetojnë. Prej krijesave të pavdekshme dhe pabregë, zoti i shndërroi në të vdekshëm dhe i dëboi nga parajsja. Ademi dhe Hava, të cilët janë prindër të parë të njerëzisë, me atë e kryen mëkatin e parë.



Ademi dhe Hava



Mëso më tepër

Lexo pjesën nga Dhiata e Vjetër për krijimin e Ademit dhe Havës dhe për mëkatin e Parë lindor.



Mendo, bisedo dhe vizato:

1. Me ndihmën e stripteknikës paraqite krijimin e botës sipas tregimeve biblike!
2. Si jetonin Ademi dhe Hava në kopshtin e parajsës?
3. Pse Ademi dhe Hava u dëbuan nga parajsja?

JETA E MUSAIT

Kush është Musai?

Sot do të dëgjojmë për jetën e Musait.

Musai është udhëheqës, i cili i shpëtoi çifutët nga robëria egjiptase.

Musai është lindur moti në Egjipt. Por, ai nuk ishte egjiptian, por izraelit. Në atë kohë faraoni i Egjiptit dha urdhër të vriten të gjithë fëmijët e porsalindur meshkuj të cilët janë izraelitë. Ta dëgjojmë tregimin për jetën Musait



Foshnja Musa

Sipas tregimit biblik për Jusufin (biri i Jakupit), çifutët jetuan mirë deri në shek. 15 p. e. r. Kur erdhi faraoni egjiptjan në pushtet, pozita e çifutëve u keqësua, dhe në fund mbetën robër të tyre. Faraoni urdhëroi të gjithë fëmijët e porsalindur meshkuj të vriten.

Musai ishte fëmijë çifut. Që ta shpëtojë nga urdhri i faraonit nëna e tij e lëshoi nëpër lumin Nil në shportë të shtresuar me katran. Shportën me foshnjë e gjeti vajza e faraonit. Ai ishte përkujdesur dhe edukuar në pallatin e faraonit. Kur u rit kuptoi për përkatësinë e tij çifute dhe pas një kohe iku në shkretëtirë. Një ditë deri sa i ruante dhentë, pa diçka të pazakonshme, shkurre që digjet, por që nuk digjen deri në fund. Zoti i drejtohet nga kjo shkurre që digjet dhe i flet të kthehet në Egjipt dhe ta shpëtojë popullin e tij nga robëria. Në këtë mënyrë Zoti e zgjodhi Musain që ta nxjerrë popullin dhe ta kthejë në tokën e premtuar – Hanaan. Musai shkoi te faraoni duke e lutur t'i çlirojë çifutët nga skllavëria . Faraoni e refuzoi kërkesën e tij. Atëherë zoti i jep fuqi Musait, që të bëjë mrekulli para Faraonit që ta lirojë popullin e tij në liri. Zoti dërgoi dhjetë të këqijat e Egjiptit, (uji në Nil u shndërrua në gjak, tokën e sulmuan bretkosat, mushkonjat, mbisundoi mortaja dhe sëmundjet e lëkurës. Breshër dhe stuhi i shkatërruan të mbjellat dhe tre ditë mbisundoi nata). Zemra e faraonit ishte aq e ngurtë sa që edhe këtë herë nuk u dorëzua. Ejani të mësojmë edhe për vërejtjen e fundit.



Zoti iu drejtua Musait prej shkurre së djegur

Zoti për herë të fundit i jep vërejtje faraonit, se gjithë fëmijët e parë meshkuj të lindur do të vdesin, derisa nuk i çliron çifutët prej robërisë. Prapë faraoni nuk dorëzohet. Pasi vdes biri i tij i parë i lindur, ai përfundimisht i lejoi Musait të e nxjerrë popullin prej Egjiptit dhe ta sjellë drejt tokës së premtuar (Hanaan). Kështu Zoti me Musanë e bënë lidhjen e tretë. Duke bredhur shumë kohë nëpër shkretëtirë e Sinasë (40 vite), njerëzit filluan të dyshojnë se do të arrijnë në tokën e premtuar. Mirëpo, Zoti e thërrret Musanë te Kodra e Sinasë ku i jepen dhjetë urdhëresat të shkruara në dy pllaka guri.



Mali i Sinait

• *Profet – Njeri i dërguar nga Zoti dhe flet në emër të Zotit.

*Profeti më i madh në dhiatën e Vjetër është Musai, prijës dhe çliruesi popullit të zgjedhur

*Populli izraelit udhëtoi 40 vite nëpër shkretëtirë.

Lidhja me Musanë

Zoti iu shpall si aleat Izraelitëve, i cili do t'ju ndihmojë. Kurse ata për borxh duheshin të i respektojnë urdhrat e tij. Urdhërat janë shkruar në dy pllaka guri, të cilat çifutët i ruanin në një sënduk ari . Sëndukun e aleancës e bartnin Çifutët në rrugën drejtë shkretëtirës. Prandaj, sënduku i aleancës ka peshë të posaçme për çifutët.



Mëso më tepër:

Shikoni filmin e vizatuar „Dhjetë urdhrat e Zotit“. Njihuni me të dhëna interesante për shkretëtirat: ku gjenden; sa janë të mëdha; a ka jetë në to dhe të ngjashme!!



Të mendojmë dhe bisedojmë:

1. Çka mendon, në çfarë vështirësi hasnin Izraelitët në shkretëtirë.
2. Shiko dhe bisedo për tekstet e ndryshme të literaturës dhe vepra figurative në të cilat është paraqitur Musai (me ndihmën e arsimtarëve të gjuhës dhe artit.)
3. Analizo ndonjë vepër artistike dhe shkruaj si artistët e përshkruajnë Musanë !
4. Çka mendoni pse figura e Musait është interesante për artin?
5. Shkurtimeisht përshkruani jetën e Musait dhe disa veti të tij.
6. A ju kujtohet ndonjë emër nga historia Çifute??

LIBRI I SHENJTË I ÇIFUTËVE

Bibla të cilën të krishterët e njohin si Dhiatë e Vjetër për popullin çifut është libër i Shenjtë. – **Tanah**. Në të është shkruar historia e popullit çifut. Pjesa më e rëndësishme e saj është Tora pesë librat e para të Biblës. Aty janë përmbajtur ligjet, përfshirë edhe dhjetë urdhërat, të cilat Jahve ia dha Musait .



Tora

Për veprat e perëndisë dhe urdhërat e tij dimë prej librit e cila në gjuhën hebraike quhet Tora.

Tora – ligj i cili është pjesë nga Tanahu,(pesë librat e para të Biblës në gjuhën hebraike) është themel i fesë çifute dhe ndryshe quhet edhe Pesëlibërs. Çifutët e shfrytëzonin Torën si prijës në jetën e përditshme. Kopje të Torave janë shkruar me dorë në tubë letre.

Tora përmban pesë libra të cilat Zoti ia dha Musait në Malin e Sinasë. 1. Krijimi 2. Dalja 3. Ligjet levitane 4. Numra. 5 Ligje të përsëritura.

Krijimi është libër për fillimin dhe krijimin e botës dhe njeriut.

Dalja është libër për daljen e popullit Izraelit prej robërisë Egjiptjane, nën udhëheqje të Musait.

Ligje levitane është libër i dispozitave, të cilat Zoti popullit të vet përmes Musait ia jep Sinasë.

Numra është libër e cila e përshkruan historinë e shpëtimit të Izraelitëve në periudhën prej 40 vitesh që jetonin dhe bredhnin nëpër shkretëtirën e Sinasë. Emri rrjedh nga dy regjistrimet e popullatës (Numërimi i Izraelitëve).

Ligje të përsëritura – temë qendrore në librin është shpëtimi dhe bekimi i popullit nga Zoti.

Libër tjetër i rëndësishme për besimtarët e Judaizmit është Talmudi. Në të janë regjistruar mendimet dhe komentet e rabinëve për përmbajtjen dhe respektimin e ligjit.



Faqe prej Talmudit



Libri i vjetër hebreik për lutje

Libri i shenjtë – Tanah përmban 24 libra, ku dallohen tre pjesë: Ligji (Peslibërshi) ose Tora, Profetat dhe Shkrime..



Djalosh që lexon Torën



Të mendojmë dhe bisedojmë:

1. Si quhet libri i Shenjtë i hebrenjëve?
2. Si është emri tjetër i Torës?
3. Prej sa librave është përbërë Tora?



Mëso më tepër:

Të shpaluarit e Torës është shumë e shenjtë që të preket me dorë, prandaj shfrytëzohet tregues, i ashtuquajtur pikëllim.



Mbaj mend:

Tora – ligji është themel i fesë hebreike, dhe i përmban pesë librat e para nga Bibla, të cilat edhe quhen Peslibërshi.

LIGJET E ZOTIT – DEKALOGU

Dekalog është emri i dytë për **dhjetë urdhrat e Zotit**. Ato janë dhjetë këshilla të mëdha për jetën e njeriut, të cilat gjenden në Torën, kurse Jahve, sipas tregimeve të biblës, ia shpalli Musait në Malin Sina. Ato ishin të shkruara në dy pllaka guri.

Vallë keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë libër që i përmban ligjet maqedonase? Për shembull, Kushtetuta e Maqedonisë? Aty hasen norma, rregulla, të cilat e rregullojnë bashkëjetesën. Edhe në Torën (pjesë e Dhiatës së Vjetër) janë të shkruar ligje dhe rregulla për jetën. Ligji më i rëndësishëm, i cili sipas tregimeve biblike u krijuan në themel të miqësisë (aleancës) ndërmjet Zotit dhe popullit të tij, është Dekalogu ose Dhjetë urdhrat e Zotit.


Të zbulojmë sa urdhëra ka në të dy pllakat e gurit!
Cilët janë dhjetë urdhërat?

Trego 10 urdhërat e tuaja, të cilat i llogarit si të rëndësishme për respektimin e të tjerëve!

Ja cilat urdhëra Jahve ia dha Musait në Malin e Sinasë..

1. Unë jam Jahve, Zoti yt, i cili të nxjori nga toka e Egjiptit, prej skllavërisë. Të mos kesh zotëra të tjrë tjerë përveç meje.
2. Mos i bëj vetes putra në asgjë, çka është lartë në qiell, ose poshtë në tokë, ose në ujë apo nën tokë; të mos i përkulesh as të i shërbesh...
3. Mos e merr më kot emrin Jahve Zotit tënd...
4. Kujtohu që ta festosh ditën e shtunë. Gjashtë ditë puno dhe mbaroi të gjitha punët. Kurse ditën e shtatë, të shtunën pusho dhe përkushtoj Zotit tënd Jahve.

** Dekalogu = Dhjetë këshillat e Zotit (urdhresa)



Musai i pranon të dy pllakat

5. Respekto prindërit tuaj që të kesh jetë të gjatë në tokë
6. Mos vrit
7. Mos bëj tradhti bashkëshortore
8. Mos vjedh.
9. Mos dëshmo rrejshëm.
10. Mos lakmo në asgjë të huajën.

Mëso më tepër

Shkruaj dhjetë urdhra tuaj që i llogaritni të rëndësishme.



Musai me dy pllaka guri në të cilat janë shkruar dhjetë urdhrat e Zotit

* Si do të ishte jeta jonë pa dispozita dhe ligje?



Të mendojmë dhe bisedojmë:

1. Vallë do të gjesh ndonjë urdhëresë të cilën e ke thënë prej këtyre dhjetë?
2. Sa jeton njeriu i sotëm në pajtim me Dhjetë urdhrat e Zotit?
3. A mund të thuhet se „ Dhjetë urdhërat e Zotit” tregojnë si të jetohet në drejtësi dhe paqe.(komento)!
4. Cilën nga urdhrat e llogarit si më të rëndësishme?
5. Prezanto një urdhëresë në mënyrë të ilustruar dhe diskutoni për të !



Mbaj mend:

Disa prej dhjetë urdhërave të Zotit i gjejmë edhe në ligjet, respektimi i të cilëve mundëson që jeta e njeriut në bashkësi të rrjedhë me drejtësi dhe respekt të ndërsjellë.




Para Murit të vajit tubohen shumë besimtar çifut

MURI I VAJIT

Nëse niseni për udhëtim nëpër internet faqet në Jerusalem, qytetit të lashtë në Izrael, do të vërejmë një mur para të cilit qëndrojnë njerëz të cilët nëpër plasaritjet vendosin letra të mbështjella . Në ato fletë të vogla shkruhen dëshirat e tyre dhe lutjet. Duke shpresuar një ditë Zoti do i plotësoj dëshirat e tyre.

Tempulli në Jerusalem ose **tempulli i Sulejmanit** ka rëndësi të veçantë në religjinin çifut sepse është dëshmi për vuajtjet shekullore dhe ngatërrimet e popullit çifut. Vendi kryesor në tempull ishte shenjtëria mbi shenjtërit në të cilën gjendej Sënduku i aleancës (lidhjes, miqësisë) të Zotit me popullin e vet. Tempullin e parë çifut e ndërtoi mbreti Sulejman. Pas shembjes së të parit, tempulli i dyti mbaroi së ndërtuari v.515 p.e.r., kurse e shembi prijësi ushtarak romak Pompej në vitin 63 p .e.r. Tempullin e tret më madhështorë e ndërtoi mbreti Herod (Irod), 9 vjet para erës së re, kurse e shkatërruan pushtetarët romak pas kryengritjes çifute në vitin 70 të erës sonë. Prej atëherë e deri më sot çifutët nuk e rindërtuan tempullin e tyre. Prej tij ka mbetur vetëm muri perëndimor që më vonë u quajt Muri i vajit. Muri i vajit është e vetmja strukturë që ka mbetur nga ajo.





Tempulli në Jerusalem, I ndërtuar nga Sulejmani, ishte shembur nga Nabukodonosor. Në Vitin 70 Tit e rrafshoi përdhe këtë tempull, të cilët e rindërtuan çifutët e kthyer prej Babiloni. Dëshmia e vetme e Këtij vendi të shenjtë është i ashtuquajturi Muri i vajit. Në fotografimin, ndërtimi i tempullit, sipas gravurës nga shek.XV.



Mbaj mend:

Më vitin 70 të erës sonë Tempulli i Irodit në Jerusalem është shembur nga romakët. Deri më sot është ruajtur vetëm pjesa perëndimore.



Mendo dhe bisedo:

Ku gjendet Muri i vajit?
Kush e ndërtoi tempullin e parë çifut (hebraik)
A është sinagoga tempull?
Si ishte emri tjetër i Murit të vajit?



Mëso më tepër:

Që kur Jerusalemi ra nën robërimin turk, sulltani Sulejmani i I, kishte raporte të mira me hebrenjtë dhe ai e ndërtoi një rënë anë të murit të kështjellës, e cila edhe sot është e dukshme. Sipas legjendës së njohur Sulejmani i I u mundua të i gjeti edhe rrënojat e tjera të vërteta të tempullit. Sipas religjionit islam, gjithashtu, është e shenjtë. Për hebrenjtë ky është i vetmi tempull që ekziston, meqë sinagogat ata nuk i trajtojnë si tempuj. Gjithashtu, sipas tyre ky është vendi i vërtetë ku Zoti drejtpërdrejt i pranon amanetet (dëshirat) e tyre.

Gjej fotografi nga Muri i vajit ose tempullit dhe bëj poster.

SIMBOLET DHE LUTJET TE JUDAIZMI

Cilët janë simbolet e judaizmit?

Si luten besimtarët hebrej?

Simbol ose emblema e popullit hebrej është ylli i Davudit (mburoja e Davudit).



Ç'është menora?

Menora është një nga simbolet më të vjetra në fenë hebreike. Ajo është shandan me shtatë krahë dhe gjendet në stemën e Izraelit së bashku me dy degë të ullirit si simbol i popullit Izraelit për paqe. Ai shandan simbolizon shkurren që digjej, të cilën e pa Musai në malin e Sinasë.



Shandan për shtatë qiri,
i quajtur menora
Simbol i rëndësishëm hebreik

Ç'është Mezuzah?

Mezuzah ndodhët mbi dyert e shtëpive hebreike. Ajo është një kuti e vogël, që përmend pjesë nga Dhiata e Vjetër. Hebreishtë quhet shema. Praqet përkujtim të obligimit fetar ndaj Zotit.



Brendia e sinagogës.

● Simbol religjioz dhe politik i Izraelit është menora, shandan me shtatë krahë, i cili e paraqet drurin e jetës.





Sinagoga

Rabin – mësues hebre fetar dhe interpretues i Torës.

Sënduku është simbol i lidhjes së Zotit me hebrejtë pasi në të i ruanin dhjetë urdhërat e Zotit.



Sënduku i marrëveshjes

Ku luten hebrejtë?

Vendi ku hebrejtë shkojnë për t'u lutur quhet Sinagogë. Sinagogat nuk janë vetëm vende për lutje, por edhe për mësim, festime dhe për shoqërime. Zakonisht lutja është në lexim të Torës dhe të lutjeve, shpesh udhëhiqet prej një mësuesi që quhet rabin.

Shenjë më e theksuar e sinagogës është sënduku, vendosur në murin lindor dhe me anën e saj të përparme është kthyer kah Jerusalemi. Sënduku përmban letra të mbështjella nga Tora të shkruara në gjuhën hebreike në pergamenë. Letrat e mbështjella janë të mbuluara me somot dhe mëndafsh. Para sëndukut ka qiri që përherë digjet.

Burra dhe gra zakonisht ulen të ndarë në sinagogë. Burrat mbajnë kapelë në kokë. Prijësi hebre shpirtëror quhet rabin. Hebrejtë janë të obliguar të luten në kohë të caktuar në mëngjes, pasdite dhe në mbrëmje. Mund të luten në shtëpi dhe në sinagogë. Çdo çifut i rritur ka obligim ta thotë lutjen „Dëgjo, Izrael“!... çdo ditë..



Rabin

Cila është dita më e rëndësishme e javës te hebrejtë (çifutët)?

Dita më e rëndësishme e javës është e shtuna (shabbat), si ditë për pushim dhe përkushtim ndaj Zotit? Kur fillon dhe mbaron dita për pushim? Dita e shenjtë çifute, ose e shtuna fillon prej perëndimit të diellit, të premten dhe vazhdon deri në perëndim të diellit të shtunën. Çifutët këtë ditë nuk punojnë.

Cilat veshje i mbajnë çifutët?

Kipah (është kapelë rrethore) në kokën e një çifuti besimtar. Ai zakonisht mban kipah, e cila e përkujton t'i përcjellë ligjet hyjnore në çdo kohë dhe në çdo vend.



Çka ndodhur në Shabbat në familjen çifute?

Në fillim të Shabbat amilja çifute ndan ushqim. Ata hanë bukë që quhet hall. Të shtunën, çifutët prezantojnë detyrë në sinagogë, të cilin shpesh e udhëheq rabin..

Gjatë lutjes, pa marrë parasysh në shtëpi ose sinagogë, çifutët nga respekti ndaj Zotit, mbulojnë kokët me kapelë, të quajtur kipah..

Tallit (shall për lutje);

Para së të fillojë me lutjen çifuti besimtar shpesh e vë tallitin. Reset e shallit e përkujtojnë në urdhërat e shumta nga Tora.



Teflin (kutizë e vogël prej lëkure me rrip të gjatë lëkure). Kjo mbahet në nënkrahun e majtë ose në ballë. Brenda në kutizë gjenden letra të mbështjella nga libri i shenjtë. Tefelini në dorën e majtë është përkujtim me gjithë zemër për ligjet hyjnore. Kurse tefelini në ballë i përkujton çifutët në të mësuarit e Torës. Tefelini mbahet gjatë lutjes në shtëpi ose sinagogë.



Ç'është ushqimi kosher?

Ushqimi kosher është ai ushqim, i cila është në pajtim me ligjet çifute. Kjo, domethënë se nuk përzihen prodhimet qumështore dhe mishtore. Nuk hanë mish derri dhe guaca



Mëso më tepër:

Gjej vizatime ose fotografi nga sinagoga dhe përshkruaje brendësinë e saj dhe jashtë.

Mendo, përgjigju, vizato:

1. Vizato simbolet e judaizmit dhe bisedo për atë që paraqet secila prej tyre.
2. Cili nga simbolet gjendet në flamurin e Izraelit të sotëm?
3. Cili vend sot e merr rolin e vendtubimit në judaizëm?
4. Si quhet mësuesi fetar çifut?
5. Tregoni klasës objektin që ka vlerë simbolike për ty, (këtu mund të përfshihet fotografi e vjetër, ari, pjese floku, robe). Tregoni klasës se edhe pse nuk kanë vlerë financiare ato janë të rëndësishme për juve. Për shembull, dhurata (suveniri) nga pushimi ju përkujton në vendin që e keni vizituar..

Hulumto për zakonet çifute në raport me jetën e përditshme.



Mbaj mend:

Sinagoga ka funksion të kuvendit ose komunës ajo shërben për tubimin e bashkësisë çifute. Në të kryhet adhurimi, interpretimi i Torës të cilin e udhëheq rabini. Në çdo sinagogë ka yll të Davidit, menorë, Torë dhe Sënduk..



Të mendojmë dhe bisedojmë:

1. Cilën ditë të javës Çifutët ia përkushtojnë Zotit?
2. Numëro disa punë, të cilat i mbajnë Çifutët gjatë lutjes!

FESTAT ÇIFUTE

Cilat janë festat kryesore çifute?

Pasha (Pesah) është festë me të cilën ngjallen kujtimet për çlirimin (lirin) e Izraelit nga robëria egjiptiane. Hahen ushqime tradicionale, këndohen këngë dhe rrëfejnë zakone të ndryshme. Festa zgjat tetë ditë.

Shavua ose Pesëdhjeta festohet 50 ditë pas Pasha, dhe është përkujtim i lidhjes të formuar në Sinaj dhe fitimit të Torës (Ligjit nga Jahve)

Rosh Hashanah është Viti i Ri çifut. Festohet në shtator ose tetor, kur toka gjelbërohet nga shirat e para vjeshtore. Atë ditë dhurohet mollë e shkrirë në mjaltë me uratën; „Shana Tova” që domethënë gëzuar Vitin e Ri. Çifutët e numërojnë kohën prej krijimit të botës. Ajo për ta është v. 3760 p . e. r. Nëse i numërojmë vitet fitojmë të dhënë se v. 2009 në kalendarin çifut është viti 5769.

Jom Kipur – Ditë e pajtimit. Ai festohet dhjetë ditë pas Rosh Hashana. Në atë ditë agjërohet dhe lutet. Agjërohet në atë mënyrë që nuk hahet dhe pihet 24 orë. Kjo ditë është edhe ditë e mjerimit, për shkak të shembjes së tempullit të Jerusalemit në vitin 70.

Hanuka - festë që zgjatë tetë ditë dhe çdo ditë ndezët nga një qiri nga menora. Kjo festë i përkujton Çifutët në fitoren për pavarësi të Judeas.

Purim është festë e lumtur dhe e dhuratave, kur njerëzit veshin kostume shkëmbehen dhurata, posaçërisht fëmijët u gëzohen dhuratave të fituara.



Festa Rosh Hashanah kremton Vitin e Ri çifut. I bihet instrumentit Shofar, që të zgjohen njerëzit dhe të fillojnë jetë më të mirë.



Festa Sukot mbahet në Vjeshtë. Me të kremtohet mënyra në të cilën çifutët e parë ndërtonin strehimore në shkretirë pas arratisjes nga Egjipti. Palma, shelgu, mirta, dhe citrioni (grejfruti) janë katër bimët që shfrytëzohen si simbol i festës



Festimi i Rosh Hashanah

Sukot – Kjo festë kremtohet në verë dhe zgjat një javë. Festa i përkujton Çifutët në qëndrimin prej 40 vitesh në shkretirë, derisa udhëtonin nga Egjipti për në Tokën e premtuar. Për këtë festë ndërtojnë kolibe të mbuluara me gjelbërim në të cilat ulen dhe gostiten.

Shevat është festë pas Hanuka . Ajo është ditë e miqve të ekologjisë në Izrael dhe kremte e „ditëlindja e drurit”.



Të mendojmë dhe bisedojmë:

1. Përshkruaji disa festa të judaizmit?
2. Përshkruaj për festën Sabat!
3. Bëj krahasimin e Vitit të Ri hebreik dhe atij krishter?
4. Shkurtimeisht përshkruajini festat Viti i Ri, Falje!
5. Nëse Viti i R i krishterë është 2009, cila është ajo hebreike?



Mëso më tepër:

Zbulo a është kalendari hebraik i njëjtë me atë të krishterë?

Hebrenjtë përshëndeten me përshëndetjen „salem”. Ajo domethënë Mirëdita, por edhe Ditën e mirë, që domethënë „paqe me ty

KRISHTERIMI

Krishterimi është religjion monoteist bazuar sipas jetës, mësimet dhe veprat e Jezuit Krishtit, sipas rrëfimit në Dhiatën e Re.

Është themeluar në shekullin e parë në Palestinë. Sot pjesa më e madhe e Palestinës njihet si Izrael. Në kohën e Jezuit ajo ishte, kryesisht, tokë hebreike me të cilën sundonin romakët. Ajo bazohet në mësimet e Jezuit Krishtit, i cili jetoi në atë tokë para 2009 vjet. Jezuit ishte lindur dhe rritur si hebrenj dhe ai përfitoi shumë ithtarë mes popullit të rëndomtë hebrenj. Mirëpo, pushtetarët fetarë dyshuan në mësimet e tij të reja dhe bënë komplot për ta kapur dhe mbytur. Në shekujt pas vdekjes së Jezuit, ithtarët tij e përhapën mësimin e tij nëpër tërë botën. Krishterimi u shfaq në kënd të përfshetur të botës hebreike. Edhe pse në fillim turpshëm, me numër të vogël për shkak mosnjohjes dhe gjykimit nga populli çifut, si dhe nga Perandoria Romake, ngadalë u përhap nëpër tërë botën. Librat e ndryshëm të shkruar nga ana e ithtarëve të Jezuit pas vdekjes së tij, quhen Dhiatë e Re, dhe bashkë me Dhiatën e Vjetër e përbëjnë Biblën krishtere. Bibla i përmban të gjitha mësimet e Jezuit dhe si të gjithë krishterët duhet t'i jetojnë jetët e tyre. Ai është religjioni më i madh botëror, me rreth 2,2 miliardë ithtarë anëmbanë botës.



Kush janë të krishterët?

Krishterët i ndjekin mësimet e Jezuit Krishtit. Krishterët janë njerëz që besojnë se Jezuiti ishte bir i Zotit, edhe e ndjekin mësimin e tij. Krishterët besojnë se Jezuiti u ngrit nga të vdekurit - u ringjall

Kush është themelues i Krishterimit?

„ Jezuiti Krishti, i cili ishte gozhdur rreth vitit 30, është themelues i Krishterimit.



Vendi i fillimit	Izrael
Themelues	Jezuiti nga Nazareti
Libri i shenjtë bibla	Dhiata e Vjetër dhe e Re
Ndërtim i shenjtë	Kisha, katedrale, kapela
Vende të shenjta	Jerusalem, Bethlehem, Nazaret
Festa më të rëndësishme	Pashkët, Krishtlindja

Besimi qendror

Sipas Biblës figura qendrore në krishterim është Jezuit Krishti. Krishterët besojnë se Jezuiti ishte Krishti ose “shpëtimtari”, i cili erdh të shpëtojë gjininë njerëzore, t’i lirojë prej të gjitha vuajtjeve dhe të vendosë jetë të drejtë. Edhe pse ai jetoi në Tokë si njeri, krishterët besojnë se ishte bir Zoti dhe prandaj ishte hyjnor. Krishterët besojnë në një Zot, për të cilin mendojnë se është i pafund dhe i amshueshëm. Ata theksojnë se Zoti është një, porse paraqitet në tri fytyra Hyjnore. Si at Zot, Zot bir dhe Zot i shpirtit të shenjtë. Kjo quhet trini e shenjtë. Trinia e shenjtë mbështetet në atë se ati Zot e dërgoi në Tokë birin e tij, ku ai fiton formë njerëzore. Ku biri i Zotit, erdhi në tokë të mësoj për dashurinë dhe shoqërim, me rëndësi është të dihet se Jezuiti, njëkohësisht, ishte edhe Zot. Ishte në tokë që ta shpëtojë njerëzimin. Në krishterimin, Zoti është i gjithfuqishëm dhe sundon me gjithçka edhe me qiellin edhe me tokën.

Jezuiti është lindur në qytetin Vethlehem. Kur Jezuiti filloi të udhëtojë nëpër tokë, ai njerëzve u fliste për Zotin. I shëronte të sëmurit. Zgjodhi dymbëdhjetë që t’i ndihmojnë në përhapjen e mësimin të tij. Ata mbetën shok të tij dhe i ndihmuan në mësimin e tij. Mësimi i tij shpesh gjykohej nga Romakët që sundonin atë kohë. Për shkak mësimin të tij Jezuitin e tradhtoi një nga nxënësit e tij. U gjykua, u shpall fajtor dhe u gozhdua në kryq.



Mëso më tepër:

Në fillim të shek. 4 mbreti Konstantin I në vitin 313 e pranon krishterimin si religjion zyrtar.

Bënë pllakat vetëm me ndihmën e fotografive (fototregim) .



Mendo dhe bisedo:

Kush është themelues i krishterimit?

Kur u paraqit krishterimi?

Pse ithtarët quhen të krishterë?



Mbaj mend:

Krishterimi është religjioni me numër më të madh në botë. Ithtarë të saj janë afër 35% nga tërë popullata, dhe të krishterët i kemi në të gjitha kontinentet Sot shumica e njerëzve janë monoteistë..

YLLI MBI VETHLEHEM

Sipas Biblës krishtere, Zoti e dërgoi engjëjlin Gabriel t'i bëjë me dije Marijes se do të jetë nënë e Jezuitit.

Jezuiti u lind në Vethlehem, ku Marija dhe burri i saj Josifi shkuan të prezantojnë në regjistrimin e popullatës, gjatë sundimit të mbretit romak Augustit. Qyteti ishte përplot dhe ata nuk kishin ku të vendosen, dhe Jezuiti u lind në një shtallë (shpellë) modeste. Bibla tregon se barinj dhe njerëz të mençur erdhën ta vizitojnë të porsalindurin. Jezuiti u rrit në Nazaret dhe me siguri mësoi zdrukthtarin, sikur babai. Prej vitit të lindjes së tij llogaritet si era e jonë. U rrit në familje çifute në Nazaret me nënën Marija dhe babanë Jakov, prandaj në Ungjillin njihet si Jezuiti nga Nazareti.

Në kodrat përreth Vethlehemit natën kur u lind Jezuiti, barinjtë që i ruanin kopetë vërejtën shkëlqim të fortë në qiell. Në qiellin u paraqit engjëll me lajmin se sot ka lindur „shpëtimtari”, i botës në qytetin e vogël Vethlehem në shpellë (stallë) mbështjellë në petk dhe i shtrirë në çerdhe. Njerëzit që panë dritën, u nisën që të binden në fjalët e engjëllit, ku me të vërtetë e panë Jezuitin foshnjë në shpellën në Vethlehem. Menjëherë u nisën për në Jerusalem për të lajmëruar lindjen e shpëtimtarit. Kur mbreti i Judes, Irodi e dëgjoi këtë i thirri të **tre të mençurit** të e gjejnë fëmijën dhe të i tregojnë ku gjendet ashtu që edhe ai të i përkulet sikur mbretit. Mirëpo qëllimi i Irodit në realitet ishte ta vrasë Jezuitin, pasi frikohej për humbjen e vendit të tij. Të **tre të mençurit** të udhëhequr nga **ylli, i cili i pasoi deri te Vethlehami**, deri te vendi ku është lindur Jezuiti, iu përkulën dhe e nderuan me dhurata pors mbret – ari, levan dhe smire. Ata kur nuk u kthyen vetëm perëndia dhe dëgjueshmëria e Josifit dhe të mençurve ia shpëtuan shpëtuan



Engjëlli Gabriel i shpall Marijes se do të jetë nënë e Jezuitit



„ Barinj dhe njerëz të pasur erdhën ta shohin Jezuitin dhe t'i gëzohen lajmit për lindjen e tij. Por, mbreti Irod ishte tepër vetjak që të gëzohet”.

jetën Jezuit te mbreti Irod. Pasi Irodi kuptoi se ishte zhgënjyer nga të tre të mençurit, menjëherë dha urdhër që të gjithë fëmijët meshkuj të vriten. Më parë Josifit iu paraqit engjëlli, i cili ia bëri me dije t'i strehojë Jezuin dhe Nënë e tij Marijen kështu që të mos pësojnë nga Irodi. Pas rrugës së gjatë dhe të mundimshme nëpër shkretirë erdhën në Egjipt. Pas vdekjes së Irodit ata kthehen në Nazaret, në rajonin Galileja



Të tre të mençurit e përdhunojnë Jezuitin



Josifi, Marija dhe Jezuiti shkojnë në Egjipt.

Mëso më tepër:

Njihu më tepër me pozitën e gruas ose fëmijëve në kohën e Jezuitit.

Shko në kishën më të afërme dhe hulumto A ekziston në mur foto Për lindjen e Jezuit.

Përshkruaje dhe vizato atë që të është më e dashur.



Mendo dhe bisedo:

1. Kush i shpalli lajmin Marisë se do të lindë djalë?
2. Ku lindi Jezuiti?
3. Sipas tregimeve nga bibla, çka i parapriu të tre të mençurve drejt Bethlehemit.
4. Mendo për ekzistimin e vërtetë të Jezuitit. Me çka dallohet nga personalitetet tjera historike ??

APOSTUJTË

Që nga kthimi nga Egjipti e deri te pagëzimi i Jezuitit, në lumin Jordani nga ana e Jovanit pagëzuesi, thuhet asgjë nuk dihet përveç se me siguri detalisht e ka studiuar Dhiata e Vjetër. Jezuiti është pagëzuar në moshën 30 vjeçare, kurse më vonë 40 ditë ishte i vetmuar në shkretirë dhe ishte nënshtruar peripetive të ndryshme të cilat i përballoi me sukses. Pas këtyre peripetive, ai fillon me veprimtarin e tij shpëtimtare. Fillon të predikojë mësim të ri nëpër rrugë dhe sheshe ku tuboheshin popull. Që prej fillimit të mësimin të tij me të ishin nxënësit-apostujtë.

Kush janë apostujtë?

Dymbëdhjetë apostujtë – nxënës të Jezuitit janë ata të cilët gjatë jetës së tij ishin shokë dhe pasardhësit e tij. Ata janë nxënës dhe mësues të krishterimit, misionarë të parë. Numri i nxënësve të Jezuitit ishte i madh gjatë historisë si dhe sot. Jezuitit ia besoi detyrën nxënësve të tij për përhapjen e mësimin të tij.



Katedralja në Valenedik - statujtë e apostujve

*misionar (deputet) – ata të cilët e përhapin krishterimin

*ungjilli – lajm i gëzuar

• Pse dymbëdhjetë apostuj?

Ky është numri i fiseve të popullit të zgjedhur hyjnor, të cilët rrjedhin nga Jakovi, Izrael

Apostujtë e parët, që i shënuan fjalët e Jezuitit dhe sipas të cilëve është quajtur Ungjilli (lajm i gëzuar) janë:

- Apostuj Petri
- Apostuj Andrej
- Apostuj Jakov
- Apostuj Filip
- Apostuj Bartolomej
- Apostuj Toma
- Apostuj Matej
- Apostuj Jakov Alfeev
- Apostuj Tadej
- Apostuj Simon
- Apostuj Juda Iskariotski



Shokët e Jezuitit (apostujtë) udhëtonin nëpër Azinë perëndimore dhe pjesët tjera të mbretërisë Romake dhe i bartnin mësimet e Jezuitit. Gjithashtu, rrëfenin se kur u gozhdua ai u sakrifikua për të gjithë ata që i besonin. Nganjëherë kur apostujtë vinin në ndonjë qytet, njerëzit i dëgjonin me vëmendje, por edhe mbetnin të krishterë (pasardhës të Jezuitit). Nganjëherë njerëzit nuk i përfillnin idetë e tyre dhe i dëbonin nga qyteti. Një çifut, që e pranoi krishterimin ishte Savle, i cili më vonë u quajt Pavle. Pavle udhëtonte gjithkrah, në Maqedoninë e sotme, Greqi, Turqi, Damask, dhe Siri, duke predikuar krishterimin. Punë e re e tij ishte ajo që ai e përhapri krishterimin edhe nëpër njerëz johebrenj. Pavle u tregonte njerëzve se Jezuiti dëshiron që të sillen mirë, të mos tregojnë gënjeshtër, të mos vjedhin ose mashtrojnë në tregëti. Por, ai u tregonte se më e rëndësishme mbi të gjitha është dashuria.

Mëso më tepër:

Mëso më tepër për apostuj Pavle Ose tjetër apostuj. Hulumto cilat kisha janë emërtuar sipas emrit të tyre.



Mendo dhe përgjigju:

1. Cili është roli i apostujve?
2. Sa janë në numër nxënësit e parë të Jezuitit?
3. Numëroi disa nga apostujtë?
4. Pse Çifutët donin ta kapnin Savle (Pavle)?
5. A ishte Pavle njëri nga dymbëdhjetë apostujtë?
6. Cilat janë vlerat e përgjithshme njerëzore të mësimëve të Jezuitit?



Mbaj mend:

Apostujtë ishin nxënësit e parë të Jezuitit, që e përhapnin krishterimin (Ungjillin).

BISEDA NË MAL



Biseda në Mal

Asnjë predikim nuk jehoi aq fuqishëm sikur Biseda në Mal. Në fillim të Bisedës Jezuiti i madhëroi dhe shpalli të bekuar të gjithë të nënçmuarit dhe të lënduarit, ata të cilët kjo botë i urren, nënçmon dhe i largon, të varfërit, ata shpirtërisht të rrënuarit që janë zemërbutë, të mjerë dhe të qarë, të etur për drejtësi, ata që janë me zemër të pastër, paqëndashës dhe të mallkuar. Pastaj flet për lidhshmërinë e Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re dhe thotë „Mos mendoni se kam ardhur t’i rrënoj Ligjin dhe profetët, nuk vij për të thyer Ligjin, por ta përmbush”.-Matej, libri i 5

Jezuiti në vend të hakmarrjes „sy për sy, dhëmb për dhëmb”, predikon „dashuro edhe armikun tënd, bekoni ata që ju mallkojnë, bëni mirë atyre që ju urrejnë dhe lutuni Zotit për ata që ju ndjekin.”Ai bëri hap të madh për paqëndashje dhe falje. Jezuiti i mësonte njerëzit të kujdesen për njëritjetrin dhe të besojnë në Zot. Ai besonte se Dhiata e Vjetër është fjalë e Zotit dhe fliste se ka ardhur ta përmbushë dhe jo ta ndryshojë atë në çka besojnë Çifutët.

Pjesa më madhe e mësimin të tij është përmes tregimeve. Jezuiti i mësonte njerëzit nëpërmjet shembujve.

Mëso më tepër:

- Përpiqu ta kuptosh mësimin e tij dhe lexoje këtë rëfim.
- Lexoje parabolën për birin e humbur

Në Dhiatën e Re hasim shumë fjalë të Jezuitit të rëndësishme për jetën e përditshme. Në Ungjillin gjej disa këshilla, drejtime të tilla dhe nënvizoi ato që i ke më të rëndësishme dhe të bukura. A mundet që ato mund të të ndihmojnë në jetën tuaj. Në cilat raste të jetës?



Mendo dhe bisedo:

1. Çka i porositi Jezuit Krishti njerëzit në fjalimin e tij?
2. Vallë fjalët e tij atëbotë ishin diçka e re?
3. Mendo vallë Jezuiti jetonte në përputhshmëri me atë që e mësoi?
4. Vallë dëshira për hakmarrje i bën njerëzit më të këqij apo më të mirë.

MREKULLITË E JEZUITIT

Sipas Biblës Jezuiti ka bërë shumë mrekullira, të cilat ishin shenja se Zoti krijoi në tokë përmes tij.

Së bashku me predikimin Jezuiti bënte gjëra, të cilat për njeriun e thjeshtë ishin të pakuptimta dhe i llogaritnin për mrekullira.

Shëronte të sëmurët nga sëmundjet e ndryshme për të cilat deri atëherë mendohesh se ishin të pashërueshme. I ngjallte të vdekurit, shëronte lëprozën, të verbërit fillonin të shohin, memecët fillonin të flasin, i qetësonte erërat, ecte nëpër sipërfaqen

Dasma në Kana – mrekullia e parë e Jezuitit

Jezuiti udhëtoi me apostujtë e tij duke përhapur shkrimin hyjnor. Një ditë Jezuiti, Maria dhe apostujtë shkuan në dasmë në Kana. Kur mbaroi vera në dasmë Jezuiti i tha shërbëtorit të mbushë gjashtë qypa me ujë. Shërbëtori kryesor piu dhe u befasua që nikoqiri e ruajti verën më të mirë për në fund. Të gjithë u habitën, sepse uji u shndërrua në verë .

Kjo ishte mrekullia e parë që e bëri Jezuiti në dasmë të thjeshtë në qytezën Kana. Me këtë ai i nxiti apostujtë të kenë besim më të madh në të..



Jezuiti i shëron njerëzit

Mëso më tepër:

Lexo dhe bisedo edhe për mrekullitë të tjera të Jezuitit.



Mendo dhe bisedo:

1. Cila është mrekullia e parë e Jezuitit ?
2. Vallë Jezuiti i shëronte të sëmurët ?
3. Cila nga mrekullitë e Jezuitit ishte më interesante për ty?



Mbaj mend:

Simbolika e mrekullive të Jezuitit është se Zoti krijonte në tokë përmes tij.

KRYQËZIMI DHE RINGJALLJA E JEZUITIT

Gjithkund nëpër botë krishterët ende tubohen në respekt të darkës së fundit, të cilën Jezuiti e ndau me shokët e tij

Kryqëzimi dhe ringjallja e Jezuitit


Krerët fetarë të Judës, duke parashikuar rrezikun nga Jezuiti, vendosën ta kapin, burgosin dhe dorëzojnë pushtetit romak, me akuzë të rrejshme kinse ka e ngritur popullin kundër Romakëve. Jezuiti i mbledhi nxënësit e vet në darkë të enjten para se të vritet. Ky takim kur ai i gostiti me bukë si simbol i trupit të tij dhe verë si simbol i gjakut të tij, quhej edhe darka e Fshehtë. Jezuiti atë natë iu tregoi se do të jetë i tradhtuar nga njëri prej tyre. Mirëpo ai mbet me ta edhe kur vijnë ta burgosin, duke llogaritur se ajo është dëshirë e Zotit. Juda, njëri nga nxënësit e Jezuitit, e tradhton. Një grup ushtarësh, të cilët erdhën te ai, e zunë Jezuitin në Malin e Ullirit. Atëherë e dorëzojnë në duart e romakut Pilat, i cili e planifikoi dhe dha urdhër që Jezuiti të kryqëzohet në kryq në vendin Golgotë. Jezuiti është veshur si „mbret” me një kurorë nga ferrat. Ai e mban kryqin deri në Golgotë.



Darka e Fshehtë nga Leonardo Da Vinçi

Jezuiti është i gozhdur dhe i mbërthyer në kryq bashkë me dy hajdutë. Me vajtje dhe mundime të mëdha Jezuiti vdes të premtën pasdite. Prej atëherë kryqi mbet simbol i krishterimit. Jezuiti ishte varrosur në shpellë. Posaçërisht pas vdekjes së Jezuitit flitej, në bazë të profetësive të tij, se ai do të ringjallet ditën e tretë. Sundimtarët Romakë vendosën roje te varri – shpella, e mbyllën me gurë të madh.


Në ditën e tretë të javës pasardhësit e tij Maria nga Magdalla dhe një grua e gjejnë varrin e tij të zbrazët. Lajmi shpejt u përhap nëpër tërë territorin çifut. Sipas ungjellit në atë nuk besonin as nxënësit e tij. Pas paraqitjes së apostujve në Malin e Galileit i bindi në vërtetësinë dhe i porosi të vazhdojnë me përhapjen e veprës së tij. Apostujtë dëshmojnë për lidhjen e vdekjes dhe ringjalljes së Jezuitit. Për Jezuit Krishtin, i cili u ringjall, apostujtë do të rrëfejnë dhe ajo do të jetë baza e krishterimit. „Nëse Krishti nuk u ringjall, atëherë feja jonë është e kotë “ - shkroi Shën. Pavle..



Kryqëzimi i Jezuitit

Mëso më tepër:

Feja, dashuria dhe shpresa janë virtytet themelore të krishterimit.



Ringjallja e Jezuitit



Mendo dhe bisedo:

1. Kush e tradhtoi Jezuitin
2. Trego për vdekjen e Jezuitit
3. Cila festë krishtere është e lidhur me këtë ngjarje?
4. Shkruaj përmbajtje për këtë festë!



Mbaj mend:

Kjo ngjarje biblike është e lidhur me festën krishtere Pashkët..

LIBRI I SHENJTË NË KRISHTERIMIN

Si quhet libri i shenjtë krishter?

Bibla është bibliotekë nga librat, vetë fjala „Biblio” domethënë libra. Nëse e shikoni menjëherë do të zbuloni se ka dy pjesë: Dhiata e Vjetër, që tregon nëpërmjet tregimeve për krijimin e tokës dhe historisë çifute dhe Dhiata e Re, e cila është tregim për jetën e Jezuitit dhe mësimet e tij. Bibla është përkthyer në 2000 gjuhë. Ekziston së paku një kopje në çdo kishë. Është shkruar rreth 1000 vjet. Përbëhet prej tregimeve, këngëve, psalmëve, lutjeve, ligjeve dhe fjalëve. Dhiata e Re përbëhet prej 27 libra: 5libra historike, 21 mesazhe (porosi) dhe Libri i Zbulesës, e cila është profetë për të ardhmen. Katër librat e para të Dhiatës së Re quhen Ungjilli, që domethënë lajm i mirë. Ungjilli sipas Markos është tregim për Jezuitin 40 vjet pas vdekjes së tij, kurse Ungjilli sipas Matej dhe Luka janë të ngjashme. Ungjilli sipas Jovanit është shkruar më vonë. Libri i dytë i Dhiatës së Re janë veprat e apostujve dhe mesazheve. Ajo flet për vitet e para të krishterimit, ç’është mesazhi dhe si të përhapet. Pavle, i cili ishte mësues shumë i rëndësishëm, shkruante letra dhe letrat e tij përmbanin shumë mësim për krishterimin e vjetër. Bibla është libri më i shitur në të gjitha kohët.



Bibla

Numëro disa emra të kishave!

Autorët e shkruanin në pergamenë dhe në papiruse të mbështjella. Të gjitha burimet e shkruara janë humbur, deri te ne arritën vetëm kopjet e tyre. Ekspertë të vërtetë në shekullin e mesëm për kopjet ishin murgjit.

Ku luten krishterët?

Vendi për lutje të krishterët quhet kishë. Shpesh ndërtohen në formë të kryqit me altar të kthyer kah lindja. Krishterimi përfshin edhe Adhurimin e Zotit përmes muzikës, fjalimit, leximi i letrave, lutje të ndryshme, biseda dhe ceremoni të ndryshme fetare.

Mëso më tepër:

*Libri i parë i shtypur është Bibla.*Bibla e parë është shtypur në gjuhën latine.

*Martin Luteri e përktheu Dhiatën e Re nga greqishtja në gjermanishte. Përkthente më shumë se 100 fjalë në ditë. Tërë përkthimin e kreu për disa javë.

*psalmë – këngë fetare nga Dhiata e Vjetër



Kishë në Sevilla



Kisha në Ohër



Mendo dhe bisedo:

1. A njihni ndonjë vepër artistike, të cilat tregojnë motive biblike?
2. A njihni ndonjë ngjarje dhe personazh për të cilët flitet në Bibël?
3. Përmend ndonjë libër, që përmban dispozita dhe ligje! Pse ekzistojnë ato dispozita? Paramendoni ditë kur nuk do të respektohej asnjë dispozitë. Përshkruaj si do të dukej jeta atë ditë!
4. Përpiquni të mblidhni të dhëna për ndonjë profet biblik!

SIMBOLET KRISHTERE

Kryqi i përkujton krishterët se Jezuiti vdiq në të me qëllim që të jenë të shpëtuar. Ai është simboli kryesor krishter.

Jezuiti ishte zdrukthëtar sikur babai i tij tokësor Josifi, por më shumë shokë të tij dhe ithtarë ishin peshkatarë. Anija e peshkimit është simbol i ithtarëve të tij, ka kryq në majë të shtizës dhe shkronjat e para nga emri i Jezuitit.



Pëllumbi është simbol i Shpirtit të Shenjtë dhe i paqes. Pëllumbesha u paraqit në pagëzimin e Jezuitit.




Simboli peshk – peshku është simbol i punuar prej shkronjave greke ICTXYC: Jezuit Krishti bir zoti shpëtimtar. ICTXYC: domethënë edhe peshk, peshku si simbol shfrytëzohej shpesh kur krishterët ishin të përndjekur. Ajo ishte shenja sekrete, që të shënohet ku do të tubohen krishterët. Shpesh shfrytëzohet edhe sot.



Mbaj mend:

Simbole të krishterimit janë; kryqi, pëllumbi, peshku, anija e peshkimit etj.



Pablo Pikaso „Djali me pëllumb,,




Mendo dhe bisedo:

1. Ku u paraqitën bashkësitë e para krishtere?
2. Çka u formua me bashkimin e bashkësive krishtere?
3. Sqaro për jetën e të krishterëve në fillim të përhapjes së krishterimit?
4. Ku tuboheshin krishterët për të predikuar mësimin e tyre?

BASHKËSITË E PARA KRISHTERE

Bashkësia e parë krishtere e formuar në Jerusaleëm. Që në fillim krishterët hasën në rezistencë të madhe në mjedisin Izraelit, prandaj shumë anëtar; të bashkësisë krishtere u detyruan të largohen nga Jerusalemi. Pasardhësit e tij apostujtë e përhapin Ungjillin në tërë Mesdheun. Feja krishtere në atë botë solli shumë risi (barabarësi ndaj gjithë njerëzve, Zot i cili i do të gjithë, dashuri ndaj të gjithëve dhe ngjashëm), prandaj ishte përqaftuar prej masave të gjëra popullore, posaçërisht në fillim nga shtresat e varfra.



Katakomba De San Genero

Bashkësitë krishtere shumë shpejt filluan të zgjerohen jashtë Izraelit dhe Palestinës nëpër tërë qytetet e perandorisë Romake, por edhe jashtë këtyre kufijve. (Siria, Azia e Vogël, Maqedonia, Greqia, Italia, Dalmacia etj.). Në mjediset ku apostujtë përhapnin mësimin krishterë hasnin në pranim, por edhe në përndjekje. Përndjekja ishte një sprovë për kishën në

kushte kur njerëzit në këto pjesë të botës ende Besonin në Zotëra Pagane dhe kryenin sakrifica. Gjithashtu, edhe të krishterët i bënë këto rituale për ta humbur frikën dhe shtypjen e mjedisit shumëhyjnorë. Por, kishte edhe shumë krishterë, të cilët ishin torturuar për shkak të fesë së tyre të Jezuit Krishtit. Për jetën e këtyre të krishterë më së miri dëshmojnë katakombet (korridore nëntokësore, të cilat të krishterëve u shërbenin për lutje dhe varrim). Në këto varreza gjendet trashëgimi e pasur kulturore për fenë dhe torturat e të krishterëve të parë në fotografi, mbishkrime, varre dhe skulptura. Një nga prijësit më të mëdhenj të hershëm krishterë ishte Shën Pavli. Shën Pavli udhëtoi nëpër tërë mbretërinë Romake, themeloi bashkësinë krishtere dhe përhapoi mësimin e Jezuit. Në vitin 313. sundimtari romak Konstantin e shpalli krishterimin për religjion zyrtar dhe përndjekja mbaroi. Me bashkimin e bashkësive krishtere u formua kisha krishtere.



Katakombi



Mendo dhe bisedo:

1. Ku u paraqitën bashkësitë e para krishtere?
2. Çka u formua me bashkimin e bashkësive krishtere?
3. Sqaro për jetën e të krishterëve në fillim të përhapjes së krishterimit?
4. Ku tuboheshin krishterët për të predikuar mësimin e tyre?

ISLAMI



Islami është religjioni i dytë i madh në botë në më shumë se 120 vende. Fjala islam është arabe dhe domethënë përkushtim në vullnetin e Zotit. Islami u shfaq në fillim të shekullit të VII në gadishullin Arabik, kurse e themelon profeti Muhamed ndërmjet viteve 610 dhe 632. Në atë periudhë ekzistonin komuna krishtere, mirëpo në pjesë të caktuara kishte edhe ithtarë të judaizmit. Ithtarët e Islamit quhen myslimanë. Themeluesi i islamit – Muhamedin e llogaritin si profetin më të madh dhe të fundit. Ata besojnë se ekziston vetëm një Zot, që quhet Allah. Ky është religjioni kryesor në Lindjen e Afërt, Azinë dhe Afrikën Veriore. Thelbësorja e islamit është besimi në një zot. Islami është religjion tejet monoteist. Libri i shenjtë islam është Kurani. Fjalët e shpallura të Mu-



Xhamia e kaltër (fillimi i shek. XVII) në Stamboll është ndër më të bukurat në botë



Kush është mysliman:

Mysliman është ithtar i religjionit islam

Çka domethënë islam?

Në gjuhën arabe fjala „islam“, domethënë dëgjueshmëri ndaj Zotit, kurse rrjedh nga fjala që domethënë paqe

Kush është Allahu?

Emrin Allah myslimanët e Përdorin për Zotin suprem dhe të vetëm, i cili krijoi të gjitha rregullat në gjithësi. Thelbi i besimit të çdo myslimani është përkushtim ndaj Allahut.

hamedit janë të shkruara në Kuran. Myslimanët shumë e vlerësojnë jetën morale. Në themel të Islamit janë pesë shtyllat e fesë për të cilat do të flasim më vonë. Në islam nuk janë të lejuara paraqitje vizuale të Zotit, pasi ajo mund të shpjerë në idhujtari.

Prejardhja	Arabia Saudite
Themelues	Muhamedi
Libri i shenjtë	Kurani
Ndërtim i shenjtë	Xhamia
Vende të shenjta	Meka, Medina, Jerusalemi
Festat kryesore	KurbanBajrami, Ramazan Bajrami



Brendia e xhamisë

Kush është themelues i Islamit?

Profeti (pejgamberi) Muhamed, i lindur më vitin 570 të erës sonë në Mekë. Arabia Saudite konsiderohet si themelues i Islamit. Ai ishte profeti i fundit i dërguar nga Allahu. Megjithatë, profeti i parë ka qenë Ademi. Ka edhe shumë profetë para Muhamedit, të cilët i pranon islami, duke i përfshirë: Ademi, Nuh, Ibrahim, Ismaili, Isaku, Jakupi, Musai (Mojsiu), Haruni, Davudi, Sulejmani, Iljasi, Junusi dhe Jezuiti (Isa)..

Mëso më tepër:

Shkruaj përmbajtje në temën: „Një ditë në familjen myslimane”. (Nëse ka mundësi vizitoni familje myslimane dhe bëni intervistë në lidhje me besimin, festat, zakonet) dhe jetën e përditshme



Taxh Mahall



Mendo dhe bisedo:

Kush është themelues i islamit?
Shpjego shkurt kur dhe si u shfaq?
Si quhen ithtarët e tij?
Ç`do të thotë fjala islam?



Mbaj mend:

Islam në shek. 7 e themelon Muhamedi. Ai është religjion mono-teist: respekton një të vetmin zot Allahun.

PROFETI MUHAMED

Kush është Muhamedi?

Profeti i fundit dhe më i madh, Muhamedi, është lindur rreth vitit 570 në qytetin Mekë të Gadishullit arabik. Myslimanët besojnë se është i fundit nga radhët e profetëve, por i përfshijnë si profetë edhe Ibrahimin, Musain dhe Jezuitin.

Muhamedi shpalli se Kurani është libri i fundit i shenjtë dhe se ai është profeti i fundit.

Rrjedh prej familje të varfër, prindërit i vdiqën kur kishte vetëm gjashtë vjet. Kur mbushi 25 vjet u martua me vejushe të pasur dhe punonte si tregtar. Shpesh shkonte në mal të mendojë. Një natë, derisa qëndronte në malin Hira, u paraqit engjëlli (Xhibraili) Gavril dhe ia zbuloi porosinë e Allahut. Kjo ndodhte shumë vite. Llogaritet se fjalët e shpallura janë shkruar në Kuran.

Muhamedi filloi t'i mësojë njerëzit përreth tij. Në vitet e para të veprimtarisë së tij nuk përfiton shumë adhurues (ithtarë), përkundrazi has në numër të madh kundërshtarë në mes politeistëve në Mekë. Për shkak



Xhamia në Medinë

Në vitin e parë Muhamedi kishte vetëm 8 ithtarë. Tre vjet më vonë Muhamedi ishte predikues, por megjithatë ende kishte pak besimtarë. Në vitin e katërt ai e shpalli shehadetin e njohur “Nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe Muhamedi është i dërguari i tij”.

RELIGJIONET E MËDHA BOTËRORE

të rrethanave të palakmueshme vendos të kalojë në Medinë në vitin 622. Medina e tërhiqte për shkak numrit të madh të ithtarëve të tij, dhe se në atë qytet kishte shumë çifutë dhe të krishterë prej të cilëve si monoteistë priste përkrahje për mësimin e tij monoteistik. Kalimin nga Meka në Medinë e shënon fillimin e kalendarit Islamik dhe quhet Hixhri. Muhamedi vdes më 8 qershor të vitit 632 në xhaminë në Medinë.



Medina

Mëso më tepër:

Sipas Kuranit, librit të shenjtë ku janë shënuar predikimet e tija gojore, thuhet se Muhamedi të vërtetat fetare i fitonte nga vetë Zoti nëpërmjet engjëllit Xhibril. Tregimet dhe bisedat u ndihmojnë myslimanëve t'a kuptojnë Kuranin dhe mësimet nga ai dhe t'i praktikojnë në jetën e përditshme.



Mendo dhe bisedo :


1. Ku dhe kur është lindur Muhamedi?
2. Përshkruaje shkurt jetën e tij?
3. Cila ngjarje shënon fillimin e kalendarit islamik?



Mbaj mend:

Muhamedi luftonte kundër politeizmit idhujtarisë dhe me forcimin e besimit në një zot krijoi bazë shpirtërore për unitet të fiseve të përçara arabe.

KURANI



Si quhet libri i shenjtë islam?

Libri i shenjtë i myslimanëve është Kurani. Besohet se i përmban fjalët e sakta të Allahut, siç iu shpallën Muhamedit. Muhamedi i recitonte gojarisht çdo varg ithtarëve të tij, të cilët i shkruanin gjithkund ku gjenin, si gurë ose lëvozhga druri. Pas vdekjes të Muhamedit, ato ishin tubuar në një libër. Besimet dhe zakonet myslimane gjenden në këtë libër. Myslimanët ndaj tij sillen me respekt të madh, pasi besojnë se u jep këshilla të thukta për jetën, të cilën Zoti dëshiron ta jetojnë. Përpiqen ta lexojnë në gjuhën origjinale arabe, gjuha në të cilën është shpallur.

Ekzistojnë përmbledhje rregullash, të cilat janë të shkruara në Kuran.

Përmban 114 pjesë(sure). Surja më e gjatë ka 286 vargje, kurse më e vogla

3. Është shkruar në gjuhën arabe në formë të prozës së rimuar. Myslimanët me kujdes dëgjojnë deri sa lexohet Kurani.

Para prekjes së Kuranit paraprin ritual i pastrimit.



Libri i shenjtë i myslimanëve –Kurani

Mëso më tepër:

Kurani mbulohet me leckë edhe më tej të mbetet i pastër dhe ta mbrojnë.

Vendoset në raft të lartë dhe mbi të të mos ketë tjetër gjë.

Para se ta lexojnë e prekin me ballë dhe e puthin ballinën e saj.




Mendo dhe përgjigju:

1. Si quhet libri i shenjtë i myslimanëve
2. Çka përmban ajo dhe si sillen ndaj saj myslimanët?



Mbaj mend:

Besimet dhe zakonet myslimane gjenden në këtë libër. Myslimanët ndaj tij sillen me respekt të madh, pasi besojnë se Kurani është nga Zoti dhe çdo fjalë është hyjnore.



QABEJA

Tempulli i shenjtë në Mekë - Qabeja

Që kur Muhamedi shpërngulet prej Mekës në Medinë, ai formon komunën e parë (Uma) ku predikon tolerancë fetare ndaj Çifutëve. Donte t'i bashkojë arabët në një shtet të fuqishëm. Në Mekë i largon të gjitha hyjnitë dhe idhuj pagane në të cilat besonin politeistët. Muhamedi fuqishëm i kushtohet monoteizmit dhe fillon të kryejë ceremoni fetare në bazë të fesë së re. **Qabeja** është tempull i shenjtë në Mekë i vendosur nën një gur të madh të kaltër të mbylltë. Sipas dijenive shkencore guri ka prejardhje meteorite. Fillimisht popujt e vjetër pagan e llogaritin për shenjtëri. Më vonë mbetet vend i shenjtë për myslimanët nga tërë bota. Paraqet shtëpi të Zotit të tyre dhe çdo vit myslimanët nga tërë bota vijnë në haxh. Qabeja është shumë e rëndësishme për çdo besimtar islam, dhe gjatë lutjeve në xhami ata kthehen me fytyrë kah Qabeja.

Mëso më tepër:

Gjatë kryerjes së haxhit, myslimanët sillen shtatë herë rreth Qabesë dhe pastaj e prekin Gurin e Zi.

Në bashkësinë Islame janë dy rryma të reja: sunite dhe shiite.



Mendo dhe bisedo:

1. Çka është Qabeja
2. Ku gjendet Qabeja?
3. Gjeje vendin në hartën gjeografike!

PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

Cilët janë pesë shtyllat e islamit?

Janë pesë obligime të çdo myslimani, të cilat duhet t'i respektojë.

Shtylla e parë është të **dëshmuarit** (shehadeti), i cili thotë: „Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhamedi është i dërguari i tij”. Kjo shtyllë është çelësi i fesë islame dhe secili që beson në këto fjalë është mysliman. Myslimanët besojnë se Allahu krijoi botën dhe gjithçka në të dhe se Ai sheh gjithçka, i plotfuqishëm dhe i gjithëdijsëm.



Dora e argjendtë që simbolizon Pesë shtyllat e islamit.

Shtylla e dytë është **namazi** (salati). Besimtari obligohet të lutet pesë herë në ditë në atë mënyrë që përkulet dhe i përkushtohet që të tregojë bindje ndaj **Allahut**. Luten para lindjes së diellit, në mesditë, pasdite, pas perëndimit të diellit dhe në mbrëmje. Lutja solemne kryhet të premtën në xhami. Gjatë lutjeve gjithmonë duhet të jenë të kthyer kah qyteti i shenjtë Meka.


Shtylla e tretë është **dhënia e bamirësisë** (zekat). Kjo nënkupton se çdo mysliman, që është i pasur detyrohet të japë lëmoshë për nevojat e të varfërve, të mos-huarve dhe të sëmurëve.

Shtylla e katërt është **agjërimi** (sijam). Myslimanët agjërojnë gjatë muajit të shenjtë Ramazan. Agjërimi nënkupton përmbajtje nga ushqimi, pija etj.

Shtylla e pestë është **Haxhi**.

Vizita e Qabesë së shenjtë në Mekë të paktën një herë në jetë për ata që kanë kushte të mjaftueshme.

Atje haxhilerët vishen në petk të bardhë të thjeshtë, që të tregojnë se janë të gjithë të barabartë. Ata 7 herë sillen rreth tempullit të shenjtë Qabesë, dhe shkojnë ose vrapojnë ndërmjet dy kodrave, Safa dhe Merva. Pastaj shkojnë në malin Arafat ku Muhamedi e mbajti predikimin e fundit të tij.



Tespihe prej 99 kokra që myslimanët i përdorin gjatë lutjeve..

Mëso më tepër:

Myslimanët anembanë botës kanë besime themelore të njëjta. Ato quhen pesë shtyllat e islamit pasi e përmbajnë fenë islame, gjithashtu sikur shtyllat në xhami në të cilën mbështetet ndërtesa.



Mendo dhe bisedo:

1. Cilat janë pesë obligimet e çdo myslimani?
2. Cilat nga këto pesë shtylla janë të pranueshme për krishterimin.
3. Përshkruaj obligimin e tretë.

FESTAT MË TË RËNDËSISHME MYSLIMANE DHE VENDI PËR LUTJE

Cilat janë festat kryesore myslimane?

Ramazani është muaj i nëntë nga kalendari islamik dhe koha kur Myslimanët anembanë botës agjërojnë .

Myslimanët besojnë se dyert e parajsës janë të hapura, kurse dyert e ferit janë të mbyllura gjatë muajit Ramazan. Gjatë kësaj feste lexohen vargje nga Kurani. Ai është muaji i adhurimit dhe pajtimit. Koha e përforcimit të lidhjeve familjare dhe të përbashkëta. Nga çdo mysliman pritet të agjërojë nga agimi deri në perëndim të diellit, pa ngrënë dhe pirë.

Festa e **Ramazan Bajramit** festohet pas mbarimit të muajit të shenjtë. Kremtohet me lutje, loja dhe dhënie të parave për qëllime humanitare.



Myslimani si lutet

Ku falen myslimanët?

Shtëpia për lutje të myslimanëve quhet xhami.



Xhamia e Larme në Tetovë


Shumë herë xhamitë kanë kulm në formë të kupës. Në të nuk ka fotografi ose skulptura. Ato janë të zbukuruara me fjalë nga Kurani nga gjuha arabe. Myslimanët mund të lutën gjithkund, me kusht të gjejnë vend të pastër dhe shtrojë. Përndryshe marrin pjesë në lutje të përbashkëta në xhami në kohë të caktuar kur i thërret hoxha nga minarja – kullë e lartë e xhamisë. Përveç faljes xhamia shërben edhe si qendër e bashkësisë, dhe ka klasa ku fëmijët mësojnë të lexojnë dhe recitojnë Kuran. Kur Myslimanët shkojnë në xhami i zbatin këpucët si shenjë se janë të pastër për falje.

RELIGJIONET E MËDHA FETARE

Aty në oborr shpesh gjendet shatërvan ose ndonjë qeshmë ku mund t'i lajnë këmbët, duart, gojën, fytyrën dhe ngjashëm. Këtë e bëjnë si simbol i pastrimit shpirtëror. Gjithmonë kur kryejnë faljen duhet të kthehen kah Meka.

Kur mbahen lutjet;

Lutjet mbahen çdo ditë në xhami. Lutje solemne kryhet të premten në xhami nën udhëheqjen e imamit.



Pamja e brendshme e Xhamisë së Larmë

Mëso më tepër:

Hulumto për festat dhe zakonet e tjera myslimane.



Mendo dhe bisedo:

1. Ku mbahet lutja e përbashkët myslimane?
2. Përshkruaje një xhami të cilën e ke parë.
3. Cila festë është e rëndësishme në islam?
4. Diskutoni për ngjashmëritë mes krishterimit dhe islamit?
5. Ngjyros me ngjyrë të gjelbër ku u paraqit judaizmi, me të kuqe krishterimi dhe me të verdhë islamin .



TEMA 4. NDIKIMET E RELIGJIONIT

- Institucionet fetare dhe shteti
- Pajtimet ndërmjet religjioneve
- Ngjashmëritë ndërmjet religjioneve
- Barabarësia dhe dinjiteti i njeriut
- Krishterimi në Maqedoni





RELIGJIONI DHE SHTETI

* **E shenjtë** – aty ku ka religjion. Ka përjetime dhe llogaritje të gjërave si të shenjta. Për të shenjtë merret ndonjë vend ose hapësirë (kisha, xhami etj.), siç ekziston kohë e shenjtë (agjërimi, festa të caktuara). Për të **shenjtë** mund të merren edhe disa fjalë, dijani të vërteta etj.

* **E shenjtë** - ajo që ka natyrë të ndryshme nga Shenjtëria. Ajo është realja, tokësore, ajo të cilës nuk i jepen attribute mbinatyrore.

Fjala shekullarizim rrjedh prej fjalës latine seakulum i cili fillimisht paraqiste emër njeriu, shekull. Shekullar domethënë të jesh i drejtuar në punët në tokë se sa në çështjet religjioze. Koncepti shekullarizim filloi të zbatohet për **ndarjen e institucioneve nga shteti**. Më konkret koncepti shekullarizim domethënë shpjegim i botës nga pikëpamjet tua pa shpjegimin me fuqi mbinatyrore. Mbisundojnë vlerat reale të së mirës, bukurës dhe drejtësisë, dhe njëkohësisht të dobësuarit e vlerave fetare. **Shekullarizim** domethënë largim qeverisjen e tyre si vullnet i Zotit. Njerëzit të pakënaqur nga qeverisja e mbretërve përgatitnin revolucion. Revolucioni u zhvillua me qëllim që të



Qeveria e Republikës së Maqedonise

barazohen të drejtat e qytetarëve. Religjionit nga pushteti shtetëror në bashkësitë fetare. Religjioni mbet pjesë e së drejtës private të njeriut. Rol të rëndësishëm në ndarjen e institucioneve fetare nga shteti ka luajtur **Revolucioni borgjez francez (1789)**. Deri atëherë ishte pjesë e pushtetit, kurse mbretët e arsyetonin.



Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Mëso më tepër:

Religjioni kohë të gjatë ishte e vetmja mënyrë për të kuptuarit e botës. Bota rreth nesh ose bota reale kohë të gjatë nuk ishte botë e vetme reale, por vetëm fenomen prapa cilës qëndron fuqi e lartë, gjegjësisht Zoti.



Mendo dhe bisedo:

1. Pse është e nevojshme ndarje të institucioneve fetare prej shtetit dhe pushtetit?
2. Bëj krahasim në çka dallohen e shenjta prej shekullares?

LËVIZJA PËR PAJTIM



Papa Jovan Pavle II është papa i parë që hyri në xhami

Mëso më tepër

Përçarjet tragjike ndërmjet krishterëve shpesh ishin të përcjella me jotolerancë dhe përjashtime, por edhe lufta ndërmjet tyre. Qysh në shek. XIX fillon afrimi i ndërsjellë i kishave të quajtura lëvizja ekumene.

Pas luftës së Dytë botërore, në Gjenevë u formua këshilli botëror për kisha. Ideja kryesore ishte bashkimi i sërishëm

Kisha krishtere ishte unike deri më vitin 1054 kur u nda në Lindore dhe Perëndimore gjegjësisht Ortodokse dhe Katolike, kurse prej shek. XVI nga Katolikja ndahet kisha Protestante.

Krishterët edhe pse të përçarë asnjëherë nuk u ndalën së luturi për bashkim dhe unitet të kishës krishtere. Ky përkushtim u kurorëzua me sukses për afrim të ndërsjellë dhe respektimit të kishave krishtere që quhet **lëvizje ekumene**.

Ekumenizmi është tendencë për pajtim, bashkëpunim, afrim dhe unitet të gjithë kishave krishtere. Në të theksohet barabarësia, uniteti, dialogu ndërmjet gjitha feve krishtere. Përpjeket ekumene si rrugë drejt unitetit krishterë është theksuar nëpërmes:

- drejtim të gjitha bashkësive krishtere përgjithmonë të kthehen kah ungjilli sepse interpretimet e ndryshme të ungjillit janë shkak për të gjitha ndarjet;

- ekumenizëm shpirtëror – lutje e përbashkët për unitet të kishave krishtere të cilat sot janë të ndara;

- dialog përmes dashurisë – takime vëllazërore dhe njohje të cilat janë të rëndësishme për krijimin e dashurisë dhe besimit të ndërsjellë;

- bashkëpunim - aksione të përbashkëta në promovimin e mirësisë së përgjithshme dhe shërbimit të njerëzve;

Ajo përpiqet të zbulojë të përbashkëtën dhe largoj atë që i ndanë



Mbaj mend:

Ekumenizmi nuk do të thotë fshehje e ndryshimeve fetareve, por zbulimi i të përbashkësës dhe largimi i asaj që i përçan besimtarët, nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit dhe dashurisë.



Mendo dhe bisedo:

1. Cilat shkaqe do t'i numërosh si motiv për paraqitjen e lëvizjes për pajtim?
2. Diskuto për shkaqet që sollën në lufta ndërfitare!
3. Jep shembuj, që tregojnë bashkëpunim ndërfitar në hapësirat tona!
4. Bëni foto poster prej shembujve të tillë!

PREJARDHJA E PËRBASHKËT E RELIGJIONEVE MONOTEISTE

Secila prej tre religjioneve monoteiste, përmban përmbledhje nga librat e shenjtë. Ato janë bazë për besimin e çdo besimtari pa dallim a është çifut, krishterë ose mysliman. Të tri religjionet kanë shpallje hyjnore siç është rasti me Ibrahimin ose Musain në religjionin hebrej, Jezuitit në religjionin krishterë ose, Muhamedi në religjionin mysliman. Edhe pse duket e ndryshme për të tre religjionet, në themel, e njohin të njëjtën Zot. Në praktikë kjo heshtet dhe disa shkenca të caktuara fetare nuk pranojnë se, në realitet, çifutët, krishterët dhe myslimanët **besojnë në të njëjtin dhe vetmin zot**. Ai është Zoti, i cili në Dhiatën e Vjetër është Jahve, krishterët e emërtojnë si Zot-Ati, kurse myslimanët me Allah. Të gjitha religjionet japin drejtime morale për jetesën e pasuesve të tij. Çdo fe i përshkruan jetën dashurin dhe familjen si shenjtëri më e madhe dhe përkushtohet për mbrojtjen e tyre.

Çdo religjion gjykon çfarëdo lloj forme të lëndimit që shkaktohet për shkak racës, fesë, pozitës shoqërore etj.



Fuqi e njëjtë krijuese



Mendo dhe bisedo:

Diskutim për pyetjet::

1. Vallë ka konflikte aty ku jetoni? (S'i t'i bindësh bashkënxënësit e tu se zgjidhja e pëlqyeshme e përbashkët, e cila i merr parasysh interesat e të gjithëve, është qasja më e mirë për këto raste).
2. Çfarë do të kishit bërë për ta rritni bashkëpunimin ndërmjet përkatësve të religjioneve të ndryshme

Mëso më tepër:

Në historinë e religjioneve ngërthehen të njëjtat figura, të cilat kanë emra të ndryshëm. Për shembull. Noe (Nuh), Avram (Ibrahim), Mojsë (Musa). Jezuit (Isai) etj.



Mbaj mend:


Lidhja e njerëzve të religjioneve të ndryshme është e nevojshme që të ruhet paqja në botë. Njeriu është qenie sociale, njerëzit nuk mund të jetojnë njëri pa tjetrin.

BARABARËSIA DHE DINJITETI I NJERIUT

Bashkëjetesa e njerëzve është e mundur vetëm atëherë kur tjetrin e nderojmë, nëse e llogarisim si të barabartë me veten, nëse dëshirojmë barazi, drejtësi dhe paqe ndërmjet njerëzve. Ato janë vlerat themelore për jetë të qetë dhe të drejtë në botë. Një nga kërkesat themelore të kohës së sotme është respektimi i të drejtave njerëzore të cilat bazohen në dinjitet të barabartë për të gjithë njerëzit pa dallim të ngjyrës së lëkurës, përkatësisë fetare, nacionalitetit, pozitës materiale ose statusit shoqëror. Por sërish, për çdo ditë vërejmë se si thyhen të drejtat njerëzore dhe fetare. Shumë shpesh nga sjellja e njerëzve mund të vërejmë se për ata ekzistojnë njerëz „më pak“ dhe „më shumë“ të vlefshëm. Njerëzit nuk vlerësohen sipas vlerave të vërteta siç janë dituria, vlerat morale etj, por sipas fuqisë dhe pasurisë që kanë. Kjo sjellje ndoshta është shkaku kryesor për padrejtësitë në botë. Në botë ka numër të madh padrejtësish, varfëri, uri, papunësi, diskriminim racor dhe gjinor, shfrytëzimi i fëmijëve dhe të varfërve.

● **Mëso më tepër:**

Shkruaj ese për aktivitete humanitare të Toshe Proeskit!



Muzeu i Nënës Terezë

NDIKIMI I RELIGJIONIT

Ndoshta nuk mundemi të ndikojmë në këto padrejtësi, por mund t'i pakësojmë padrejtësitë në mjedisin tonë. T'u ndihmojmë të tjerëve me atë që kurdo të ketë nevojë, t'i mbrojmë kur janë të rrezikuar, të jemi solidarë me ata që pësojnë. Historia njerëzore është e përmbushur me konflikte të përhershme midis popujve. Miliona njerëz i kanë humbur jetët e tyre në luftëra të ashpra. Shumica e këtyre luftimeve janë bërë në bazë ndërfetare. Mendohet se me armë mund të vendoset paqe në botë, mirëpo paqja nuk vendoset me armë, por me drejtësi, respektim të ndërsjellë, respektimi i pronës së huaj etj. Prandaj arma më e fuqishme në luftën për paqe është dashuria..



Misioni i Nënës Terezë

• Numër i madh i institucioneve fetare kanë falur mjete për ndërtim të spitaleve, qendrave për ndihmën e fëmijëve, shkolla, aparate mjekësore si dhe ndihma të përditshme për të varfërit dhe njerëzve të rrezikuar.



Mendo dhe bisedo:

1. Përmend ndonjë figurë të rëndësishme për bashkëpunim ndërfetar dhe kontributi i tij për njerëzinë.
2. Luteni arsimtarin t'ju shpjegojë për misionin për falje të papës Jovan Pavle, misionit të Nënës Terezë, pishtare e paqes..


BASHKËSIT RELIGJIOZE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

Krishterimi në Maqedoni

Krishterimi në Maqedoni paraqitet në shekullin e parë të erës sonë, kur këtë territor e vizitoi **apostuj Pavle** dhe formoj bashkësi krishtere. Ajo ishte periudhë kur Maqedonia ishte nën sundimin Romak. Në atë periudhë paria Romake nuk lejonte pranimin e fesë krishtere dhe krishterët ishin përndjekur. **Pas njohjes të krishterimit si religjion zyrtar edhe në Maqedoni u organizua kisha.** Ndikim më të madh në përhapjen e krishterimit kishte vepra e vëllezërve Qirili dhe Metodij. Me formimin e Universitetit të parë në Ohër filloi përkthimi i pjesëve nga Bibla, libra kishtar dhe jetëshkrimeve. Me rëndësi të veçantë për shkrimin dhe përhapjen e krishterimit është vepra e **Klimentit** dhe **Naumit**, si dhe veprimtaria e e nxënësve tjerë, të cilët dolën nga shkolla e Ohrit. Më vonë nëpër shekujt ka shumë ngjarje që ndikonin mbi jetën kishtare në

Mëso më tepër:

Lufta për pavarësi të kishës Ortodokse Maqedonase duke u mbrojtur nga politikat kish-tare Bullgare, Greke dhe Serbe, vazhdoi deri në gjysmën e dytë të shek 20. Shpartallimi i perandorisë turke dhe rënia e Maqedonisë nën ndikimin e pushtetit serb në Mbretërinë e Jugosllavisë domethënë edhe rënie e kishës nën kishën ortodokse serbe. Pas luftës së dytë botërore, Maqedonia, pasi luftoi për sovranitetin e vet në kuadër të RFSJ, filloi çështja për autonominë e KOM.



Përmendore e Shën. Qirilit dhe Metodit në Ohër



Sh. Pantelejmon, Shkup

territorin e Maqedonisë. Pavarësinë e vetë të plotë Kisha Ortodokse Maqedonase e shpalli më 17 korrik 1967, në mbledhjen e Tretë kishtarë në Ohër, si trashëgimtare e arqipeshkopisë së Ohrit. Kryepeshkopi i parë i Kishës Ortodokse Maqedonase ishte **mitropolit Dositej**.

Bashkësia Islame Fetare në Republikën e Maqedonisë

Bashkësia Islame Fetare në Republikën e Maqedonisë, është organizatë fetare e të gjithë myslimanëve që jetojnë në hapësirën e Republikës Maqedonisë. Ajo është institucion përgjegjës për zhvillimin e jetës fetare të myslimaneve; organizon mbajtjen e punëve fetare të besimtarëve dhe i përcakton detyrat dhe obligimet e tyre. Ajo i mbron dhe kultivon vlerat morale, sociale, ekonomike, kulturore, arsimore dhe të tjera të anëtarëve të saj. **Bashkësia Islame i përfaqëson myslimanët në këtë nën qiell në vend dhe diasporë dhe i mbron interesat e tyre në të gjitha fushat e jetës.** Nga paraqitja Islamit në hapësirat tona, myslimanët e Maqedonisë ishin tërësi e pandarë shpirtërore Islame të cilët i trashëguan mësimet e Kuranit. Që t'i realizojnë detyrat e tyre fetare, myslimanët u lidhën në të vetmen Bashkësi Islame, pa dallim të nacionalitetit ose përkatësisë etnike. Qëllimi i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë është ngritja e vetëdijes fetare, organizimit dhe jetësimit të Islamit.

Që të përmirësohet bashkëpunimi i ndërsjellët dhe informimi ndërmjet bashkësive fetare në Maqedoni, si dhe të informohet publiku për aktivitetet e saja mbahen **Ditët e bashkësive fetare**.

Përkrah këto bashkësi fetare ekzistojnë edhe bashkësitë të tjera fetare në Republikën Maqedonisë, të cilat kanë të drejtë lirisht ta praktikojnë fenë e tyre.



Tempulli i Omerit

E kaluara e civilizimit njerëzor dëshmon për numër të madh shembuj të jotolerancës fetare. Jotolerancë më e madhe ekzistonte në të kaluarën e largët, por gjeneratat e ardhshme jo gjithmonë mësonin nga gabimet e të kaluarës. Rruga drejt tolerancës dhe bashkëpunimit në shoqëri u zhvillua me hapa të vegjël, por, hapa të njëpasnjëshëm, kurse përparimi nuk ishte gjithmonë i njëtrajtshëm. Nëse në ndonjë periudhë historike ka ekzistuar toleranca, ajo ka qenë e kufizuar vetëm ndërmjet disa bashkësi fetare. Qysh në civilizimin bashkëkohor vjen deri në shkallë të tolerancës, e cila së paku mund të i kënaqë të gjitha bashkësitë fetare.



Mendo dhe bisedo:

1. Cilët figura luajtën rol të rëndësishëm në përhapjen e krishterimit?
2. Në cilën mbledhje kishtarë u shpallë pavarësia e KOM?
3. Cili është kontributi i vëllezërve Qirili dhe Metodij për përhapjen e krishterimit.
4. A mendoni se Ditët e bashkësive fetare janë të dobishme dhe të nevojshme?

LEKSIKON I KONCEPTVE MË PAK TË NJOHURA

A

*apostuj

-shiko dymbëdhjetë

*Ibrahimi

-sipas biblës Ibrahimi është i pari nga tre patriarkët e popullit Izraelit. Jetoj rreth vitit 1850 p.e.s. Ai quhet , babai i Izraelit”

*Allah

-sipas besimit islam ky është emri personal i Zotit. Allahu është i vetmi zot, i amshueshëm dhe i plotfuqishëm, krijues i botës.

*ateistë

-njerëz, të cilët nuk besojnë në Zot ose hyjni.

B

*Bibla

-Bibla është libër i shenjtë për çifutët dhe krishterët. Bibla është përmbledhje e më shumë librave, e cila përmban gjithsej 73 libra; 46 libra të dhiatës së Vjetër dhe 27 libra të dhiatës së Re. Koha para Jezuitit quhet Dhiata e Vjetër, koha pas Jezuitit quhet Dhiata e Re.

D

*Dekalog

-emër tjetër për dhjetë urdhrat e zotit të shkruara në dy pllaka guri që zoti i ja dha Musait në malin e.

F

*Faraon

-emër për sundimtar të lashtë egjiptian . Në pajtim me besimet egjiptiane, faraoni varroset në piramida ku vazhdojnë të jetojnë edhe pas vdekjes prej nga ngjiten në qiell. Përmenden edhe në Bibël, në përshkrimet e Ibrahimit, Jusufit, Musait, Davudit dhe Sulejmanit.

H

*Hanaan

-në librin e shenjtë tokë hanaane quhet pjesë e Palestinës në pjesën perëndimore nga shteti Jordan. Izraelitët, Hanaan, e quanin tokën e premtuar pasi Zoti ua premtoi popullit Izraelit.

*hixhri

-shpërngulja e Muhamedit dhe ithtarëve të tij nga Meka në Medinë në v.622. Ajo është viti fillestar i fesë islame.

*hyjni

-emra për zotëraa dhe fantazmë në religjionet primitive, të cilat sundonin me botën dhe me fuqitë mbinatyrore

I

*idol

-Objekte, statua ose fotografi të cilës i përshkruhet fuqi hyjnore dhe ndaj së cilës tregohet përkushtim sikur ndaj zotit.

*Izraeli

-populli izraelit e mori emrin sipas peshkop Jakov, i biri i Isakut, i cili quhej Izrael dhe nga i cili rrjedhin dymbëdhjetë fiset Izraelite.

*islam

-një nga religjionet e mëdha monoteiste. Besimi i cili bazohet në Kuranin, i cili u shpall Muhamedit. Në Islam ka pesë obligime ose shtylla; 1, deklarimi i fesë, 2, namazi; 3 agjërimi, 4, kontributi fetar i domosdoshëm (zeqat). 5. harxhi në Mekë.

J

*Jahve(JHVH)

-emri më i shpeshtë për zot në Dhiatën e Vjetër. Domethënë,, ai", jam ai që jam. Izraelitët nuk guxonin ta përmendin emrin e tij, në vend të tij thoshin Adonaj ose zotëri.

*Jezuiti

-Jezuiti (hebr, Jesuah, shpëtimtar, shpëtim), emri i Jezuitit nga Nazareti, themeluesi i krishterimit, u lindë në Bethlehem ndërmjet vitit 7 dhe 4 p.e.s. Vdesë i gozhduar në kryq kur mbushi 30 vjet, u ringjall prej të vdekurve dhe shkoi në qiell . Jezuiti nuk shkroi asgjë, kurse porositi e tij (ungjilli) i shënuan nxënësit e tij, apostuj dhe evangjelistë, në Dhiatën e Vjetër.

*judaizmi

- fe çifute.

K

*katakombi

-korridore nëntokësore të cilat krishterët e parë i shfrytëzonin si varreza dhe vende për lutje. Më të njohura katakombe u krijuan në Romë, Napoli dhe Aleksandri.

*Kisha

-bashkësi e njerëzve që besojnë në Jezuit Krishtin Vend ku bashkësia krishtere tubohen gjatë lutjes.

*Kurani

-Kurani është libri shenjtë i Islamit. Sipas mësimit të Islamit përmban shpalljen e zotit. Është shkruar në gjuhën Arabe. Ndahet në 114 sure(kreu)

*Krishterët

-Krishterë janë nxënësit e Jezuit Krishtit dhe besimtarët. Emri krishterë (gr. hristianos),vjen nga emri Hrist (gr.Hristos=i përkëdhelur). Te krishterët sot janë ithtarët e bashkësisë fetare me numër më të madh, rreth 35% të mbarë popullatës botërore.

M

*magji, votëbesim

-besim në ekzistimin e fuqive mbinatyrore në të cilat njeriu mund të ndikojë me ceremoni të ndryshme për arritjen e qëllimeve të caktuara të mira ose të dëmshme.

*Meka

- qytet i shenjtë i religjionit Islamik i cili gjendet Arabi Saudite, vendlindja e Muhamedit.

*minare

-kullë e lartë dhe hollë prej të cilës myslimanët thërrasin në namaz.

*misionar

-në krishterimin, personazh i cili predikon fenë krishtere.

*monoteizëm

-besim në ekzistimin e një zoti i cili përjashton ekzistimin e zotërave të tjerë. Religjione monoteiste janë krishterimi, judaizmi dhe islami.

***Muhamed (570-632)**

-Profet i Allahut dhe themeluesi i Islamit. Predikon religjion monoteist me burimin themelor Kuranin.

***Musai**

-Musai, prijës fetarë çifut dhe ligjdhënës, jetoi në vitin 13 p.e.s. Sipas biblës, ai është ndërmjetësues ndërmjet zotit dhe popullit çifut, profeti më i madh i tyre, i cili i nxori nga robëria Egjiptiane nëpër detin e Kuq dhe shkretës Sinai deri te kufiri Kanaan . Në Sinai i pranoi pllakat e ligjit (dhjetë urdhrat) i ja shpalli popullit të tij si ligj fetar themelor i bazuar në lidhjen ndërmjet Jahve dhe Izraelit.

N

***Nazaret**

-qytet në krahinën Galileja, qytet ku jetoi Jezuiti.

P

***Pagan**

- ithtarë të religjionit politeistë.

***parabolë**

- tregimet të bukura në të cilën mendimet kryesore shprehen me krahasime fotografike . Ato ngërthejnë ndonjë mësim religjioz dhe moral.

*** Pasha**

- Pasha është fjalë greke prej pesah, që domethënë kalim . Pasha është festë kryesore çifute, ishte shumë e vjetër dhe me siguri ekzistonte edhe para kohës së Musait. Në atë ditë barinjët i dhuronin kurbane Zotit. Më vonë kjo festë u lidhë me ndaljen e izraelitëve prej robërisë egjiptiane në liri. Pasha çifute festohet 7 ditë, kur se fillon me darkë pashale. (gosti)

***papyrus**

-material për shkrim në Egjiptin e Vjetër, ngjashëm me letrën.

***politeizëm**

- shumëzota . Besimi në më shumë zota .

***popull i zgjedhur**

-populli Izraelit ishte i vetëdijshëm se zoti në mënyrë të veçantë i zgjodhi, se me ta Zoti lidhi aleancë . Popullin e Izraelit e quajmë popull të vjetër të zgjedhur hyjnor. Jezuiti e themeloi kishën në të cilën thirren të gjithë njerëzit të tubohen në një popull hyjnor.

***psalme**

-psalme(prej greqishtes .psalmos = këndim ose këngë me instrument me tel ose frymor janë përmbledhje prej 150 këngëve të dhiatës së vjetër biblike.

***profet**

- sipas biblës janë njerëz të cilët zoti i mëveshti me aftësi të posaçme.

Q

***Qabeja**

- Shenjtëri kryesore islame dhe vendi ku myslimanët shkojnë Haxhi, në Mekë.

R

***rabin**

- mësues fetar çifut.

***Ramazan**

- muaji i nëntë në vitin Islamik, sipas ligjit përshkruhet agjërime i ashpër i besimtarëve/

***religjion**

- besim në Zot, dashuri ndaj Zotit, të jetuarit në pajtim me dispozitat e fesë.

S***sabat**

-në religjionin çifut, ditë e dedikuar Zotit. Sabah është ditë për pushim dhe lutje.

***sinagoga**

-venë për tubim të bashkësisë çifute për lutje.

*** sënduku i lidhjes**

- sënduku i lidhjes shpesh përmendet në dhiatën e Vjetër. Në të ruheshin pllakat me dhjetë urdhrat të cilët i përkujtonin Izraelitët në lidhjen e Sinasë.

T***Talmud**

-përmbledhje e madhe ë shkrimeve për interpretimin të Torës nga rabinët;Përmban mendime dhe komente të interpretimit rabin të Torës.

*** toka e premtuar**

-toka e premtuar është Palestina, nga e cila zoti e bartë Ibrahimin. Populli Izraelit besonte fortë se Zoti ua dhuroi atë tokë si dhuratë e merituar, që të jetojnë në të si popull i zgjedhur, i cili botës do t'i shpallte mirësinë hyjnore dhe dashurin ndaj tërë njerëzisë.

***Toleranca**

-Durueshmëri ndaj botëkuptimeve të huaja, edhe pse me to njeriu nuk pajtohet, veçanërisht për çështje fetare dhe ngjashëm.

***Tora, Ligji, Peslibërshi**

-Çifutët, krishterët dhe shumë të tjerë, respekt të veçantë i kushtojnë Ligjit(çifute Tora) ose Peslibërshit të Musait. Ajo është përmbledhje nga pesë libra të shenjtë në të cilat përmbahen ngjarjet më të rëndësishme nga historia fetare e popullit të zgjedhur.

U***ungjilli (libra)**

ungjilli katërtë (sipas Matej, Marko, Luka dhe Ivani)në mënyrat të ndryshme e përshkruajnë jetën mësimin dhe veprimtarinë e Jezuitit.

Xh*** xhami**

-Vend për lutje ku tubohen bashkësia islame.

PËRMBAJTJA

PËRKUFIZIMI I RELIGJIONIT	7
Të qenët religjioz	9
Ç'është religjioni?.....	11
Përkufizimi i koncepteve politeizëm dhe monoteizëm	13
Kur dhe ku u krijuan besimet e para religjioze	15
Njeriu, natyra, fuqitë natyrore	17
Bashkëpunim dhe lidhshmëri – në vend të përçarjes	19
Njerëzia	21
Religjioni dhe etika	23
BESIMET E PARA FETARE	25
Animizmi	27
Totemizmi	29
Sistemi i ndalesave të posaçme	31
Përralla	32
Çka janë mitet?	34
Krijesat(fenomene)mitologjike.....	38
Magjia	41
Magjia, religjioni, shkenca	42
RELIGJIONET E MËDHA BOTËRORE	45
Judaizmi	47
Dhiata – marrëveshja.....	49
Krijimi i botës	50
Jeta e Musait	52
Libri i shenjtë i Çifutëve	54
Ligjet e Zotit – dekalogu.....	56

Muri i Vajit	58
Simbolet dhe lutjet në Judaizëm	60
Festat Çifute	64
Krishterimi	66
Ylli mbi Bethlehem	68
Apostuj	70
Biseda në Mal	72
Mrekullitë e Jezuitit	73
Gozhduarit dhe ringjallja e Jezuitit.....	74
Libri i shenjtë në Krishterimin	76
Simbolet krishtere.....	78
Bashkësitë e para krishtere	79
Islami	80
Profeti Muhamed	82
Kurani	84
Tempulli i shenjtë në Mekë-Qabja	85
Pesë obligimet e Islamit	86
Festa më e rëndësishme myslimane dhe vendi për lutje.....	87
NDIKIMI I RELIGJIONIT	89
Religjioni dhe shteti	91
Lëvizja për pajtim	93
Prejardhja e përbashkët e religjioneve monoteiste	94
Barabarësia dhe dinjiteti i njeriut	95
Bashkësitë fetare në Republikën e Maqedonisë	97
LEKSIKON PËR KONCEPTET MË PAKË TË NJOHURA.....	100